



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI**  
*Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 06.05.2020, ora 09:00

**Drejtojnë mbledhjen:**

**Damian Gjikhuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë**

**Rend ditës:**

Informacion lidhur me ecurinë e procesit të reformës zgjedhore nga momenti i krijimit të këshillit politik, me pjesëmarrjen e opozitës jashtëparlamentare, deri në fillim të muajit mars, kur puna u ndërpre për shkak të situatës me COVID-19.

**Marrin pjesë:**

Damian Gjikhuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Arben Elezi, Blerina Gjylameti, Klotilda Bushka, Korab Lita, Myslim Murrizi dhe Ralf Gjoni.

**Mungojnë:**

Bashkim Fino dhe Adriatik Alimadhi.

**Të ftuar:**

S'ka.

## HAPET MBLEDHJA

**Damian Gjikhuri** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Faleminderit që jeni në këtë lidhje *online* për mbledhjen që kemi lajmëruar!

Siç edhe e kemi bërë të ditur më parë, pas shtyrjes së mandatit të reformës zgjedhore nga Kuvendi i Shqipërisë, lipsi nevoja dhe ne si drejtues të këtij komisioni, nisur edhe nga procesi politik paralel që është zhvilluar për konsultimin me opozitën jashtëparlamentare për miratimin e Kodit Zgjedhor, menduam që të zhvillojmë njëseancë informuese. Natyrisht, ne do të bëjmë edhe ndonjë diskutim, ku do të informojmë për hapat që kemi ndjekur, njëkohësisht, edhe për qasjen që do të kemi në të ardhmen.

Ju e dini që afati i këtij komisioni (unë këtu jam me bashkëkryetaren, zonjën Hajdari, e cila besoj se do ta marrë fjalën më vonë), pra afati që i kemi vënëvetes ne si Kuvend, është data 30 qershor. Njëkohësisht, për shkak të situatës së COVID-19, për rrethana që nuk vareshin nga ne, në mënyrë të paparashikuar, puna e këshillit politik u ndërpre. Kjo bëri që të mos kishim një produkt final për çështjet, të cilat ishin në diskutim. Pikërisht për këtë, siç ju thashë, e ndiej të arsyeshme t'ju informoj se në çfarë stadi jemi dhe se si do të vazhdojmë më tej.

Natyrisht ky ka qenë një proces jo shumë normal, pasi u përfshi edhe një komponent politik, që nuk është pjesë e Kuvendit të Shqipërisë, por me koshiencë e kemi bërë këtë, sepse edhe dëshira ka qenë që të kemi një ligj zgjedhor të gjithëpranuar.

Së dyti, tashmë reforma zgjedhore, së bashku meligjin “Për financimin e partive politike”, është kthyer një nga çështjet kyçe për hapjen e negociatave, e cila duhet të realizohet, pra një detyrë, e cila duhet të realizohet nga Shqipëria para konferencës ndërqeveritare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuesve të Bashkimit Europian. Nga kjo lindi nevoja që duhet t'i mobilizojmë të gjitha forcat tona politike, të gjitha energjitë tona, në mënyrë që këtë raport ta realizojmë në kohë dhe t'i japim Shqipërisë një ligj zgjedhor, ashtu siç kërkohet.

Unë kam pasur kontakte të vazhdueshme me faktorin ndërkombëtar edhe ditët e fundit dhe ka qenë një thirrje dhe një interesim i vazhdueshëm që është momenti i duhur për ta rifilluar këtë proces aty ku e kemi lënë. Pra, atë proces që na ka mbetur në mes për shkak që, siç e thashë, nuk vareshin nga ne dhe tashmë të gjithë i dimë.

Pak më parë u ngrit një shqetësim në lidhje me pjesëmarrjen këtu, sepse, përveç anëtarëve të komisionit, të cilëve edhe një herë iu uroj shëndet dhe më vjen mirë që janë të

gjithë shëndosh e mirë dhe komunikojmë, ne kemi,gjithashtu, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare,të cilët janë pjesë integrale e këtij procesi. Të mos harrojmë se qëkur e kemi ngritur Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore, ne kemi disa palë direkt të interesuara në këtë proces, jo vetëm në këshillin politik, sepse ata patjetër kanë qenë pjesë integrale e këtij procesi, por edhe në komision, ato që janë parashikuar në Kodin Zgjedhor, që normalisht duhet të integrohen aty, do të bien, dhe precedencën do ta marrë ligji, që do të jetë i plotë. Besoj se do të jetë faza e dytë, dhe ky do të jetë një ligj shumë i rëndësishëm, siç kërkohet edhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Ka dy-tri çështje të mprehta, për të cilat nuk kemi gjetur dakordësi, dhe do t'i them. Unë i shikoj problematike nga mënyra se si janë formuluar.

Së pari, është çështja e administrimit zgjedhor. Për çështjen e administrimit zgjedhor ekspertët kanë përgatitur një material të mirë për depolitizimin e administratës zgjedhore. Partia Demokratike erdhi me një sistem miks politik dhe civil, nëse do ta quaj të tillë, që unë mendoj se nuk është i duhur, megjithatë, duke mos dashur të paragjykoj propozimet e tyre pa e prerë se cili mund të jetë variant më i mirë, ne i jemi drejtuar ODIHR-it. Do ta ripërsëris këtë kërkesë, meqenëse këtu është prezent përfaqësuesi i ODIHR-it, që për propozimet e sjella duhet të analizohet se cila nga ato arrin në mënyrë standarde rekomandimet e kahershme që kanë të bëjnë me profesionalizimin, me depolitizimin dhe me departizimin e administratës zgjedhore. Pra, kjo është një çështje që meriton të adresohet dhe pikërisht roli i ODIHR-it është shumë i rëndësishëm.

Kemi edhe disa mosdakordësi të çështja e kuotave gjinore, por ODIHR-i na ka ndihmuar me dokumente pune shumë të vlefshme; na ka treguar se çfarë mund të realizohet, si mund të bëhet zëvendësimi, cila është në përputhje me parimet e përgjithshme dhe me frymën e rekomandimeve të tyre për realizimin e kuotave gjinore. Besoj se këtu nuk do të kemi ndonjë shqetësim.

Kemi rënë në një dakordësi parimore, por jemi duke diskutuar për datat dhe për periudhat zgjedhore. Besoj se diçka, fatkeqësisht, ka dalë edhe në media, siç spekulohet këtu. Por, unë po them se në periudha zgjedhore qëllimi ka qenë që të afrohet, të eliminohen muajt e nxehtë, sepse Shqipëria është vend i ngrohtë dhe ka turizëm. Qëllimi ka qenë që zgjedhjet të zhvillohen mes muajve prill dhe maj dhe në muajt fund tetori, mes nëntori. Kjo është një periudhë zgjedhore shumë e mirë, sepse nuk e dëmton industrinë e turizmit dhe njëkohësisht klima është shumë e përshtatshme për të zhvilluar fushata zgjedhore. Besoj se ky është një

interes i përbashkët i të gjitha palëve dhe nuk cenon asnjë parim, përkundrazi, është një diskrecion që e kanë vetë vendet.

Për çështjen e administratës zgjedhore, siç e thashë, ka një përpjekje nga ekspertët për të diskutuar një formulë që mund të adresojë disa shqetësime edhe të opozitës, megjithatë unë nuk dua ta ndaj për momentin këtë, dhe duhet të më mirëkuptoni, sepse jemi duke negociuar.

Unë u shqetësova nga deklaratat që ka bërë dje Partia Demokratike, ku thoshte se kanë bërë 5 kërkesa, sikur donin të thoshin se kanë bërë ultimatumin e tyre dhe nuk kanë nevojë të ulen më në tavolinë. Shpresoj që, meqenëse nuk e kam dëgjuar përfaqësuesin ose kryetarin e Partisë Demokratike, të mos jetë kjo linja zyrtare e opozitës së bashkuar. Unë do të vazhdoj të insistoj që ne të dialogojmë aty ku e kemi lënë, pasi, e theksoj, ky komision dhe ky parlament, pavarësisht nga ndasitë që ne kemi, jemi një parlament legjitim, që i kemi votat për të miratuar ose për të mos miratuar nëse nuk bëhen votat, pra është e rëndësishme që ky parlament ka legjitimitet të plotë, që ky proces të mos mbetet peng i tekave të opozitës, përkundrazi, me vullnetin e mirë ne kërkuam që ky proces të hyjë në shinate dialogut, me qëllim që ligji zgjedhor të jetë gjithëpërfshirës.

Për sa i përket çështjes së sistemit zgjedhor, jam shumë i sigurt që opozita parlamentare, që është pjesë e këtij komisioni, ka këmbëngulur fort, dhe të them të drejtën, vetëm përfaqësuesit e opozitës parlamentare kanë sjellë propozime për sistemin zgjedhor. Ne iu drejtua ekspertëve me disa pyetje për propozimet që janë sjellë, nëse ato propozime prekin Kushtetutën apo janë në kompetencë të parlamentit për t'i adresuar në Kodin Zgjedhor. Besoj se ekspertët shumë shpejt do të na përgatisin një opinion për t'ia shpërndarë të gjithë të interesuarve, duke përfshirë patjetër anëtarët e këtij komisioni, pasi këtu fillojmë të dalim në një plan tjetër. Pra, nëse do të prekim Kushtetutën, si do ta prekim, do ta adresojmë në një mënyrë tjetër dhe jo thjesht vetëm brenda këtij komisioni zgjedhor.

Nga kjo pikëpamje, pasi të vijnë këto përgjigje, duhet të ulemi dhe të gjykojmë natyrshëm, duke gjetur modusin apo raundin dhe, mbi të gjitha, konsensusin, sepse çështjet e sistemit janë çështje diskrecioni politik për vende sovraane. Asnjë institucion ndërkombëtar nuk mund të japë një formulë apo një recetë për sistemin, përkundrazi, ajo kërkon një konsensus politik të gjerë.

Duhet të them se Partia Demokratike nuk ka sjellë propozim për sistemin, megjithëse ka pasur deklarime publike. Nuk e di, jam i habitur me këtë, sepse thanë që do t'i sillnin. Kjo tregon se ata ndoshta nuk kanë dëshirë të ketë ndryshim sistemi, megjithatë kjo mbetet për t'u parë.

Ne po diskutojmë dhe me sa kuptoj pjesa e sistemit do t'i ngelet këtij komisioni për ta diskutuar dhe do të jetë objekt pune i këtij komisioni natyrshëm, pasi këshilli politik nuk solli propozim për sistemin. Në këtë mënyrë ne, si komision, do ta hapim shumë shpejt atë temë, që ta diskutojmë së bashku. Si përfaqësues i maxhorancës dhe i PS-së nuk mund të shprehem për sistemin aktualisht, pasi duhet parë. Edhe ne mund të kemi dëshirat tona për sa i përket sistemit, por është diçka që duhet negociuar para se ne të shpalojmë pikëpamjet tona, pasi ndryshe nuk do të gjejmë dakordësi. Ndryshimi i Kushtetutës kërkon një maxhorancë super absolute, që do të kërkonte një konsensus shumë më të gjerë.

Me pak fjalë, pa u dashur të zgjatem, sepse nuk dua të bëj monolog këtu, informacioni është i plotë edhe për ato që janë arritur. Për shembull, PD-ja ka kërkuar disa elemente. Për sinjalizuesit kemi gjetur zgjidhjen ligjore, që është një standard i arritur. Partia Demokratike, fatkeqësisht, kishte edhe disa pretendime të tjera, që mendoj se edhe nga ekspertiza e ODIHR-it do të na jepet një opinion për hapjen e të gjitha kutive, rinumërimin para daljes së rezultatit. Mendoj se kjo gjë është destabilizuese, sepse nuk ka një praktikë të tillë, përkundrazi ne kemi rënë dakord edhe në draftin që kemi punuar si komision pa pjesëmarrjen e opozitës jashtëparlamentare, dhe kemi thënë që për efekt të integritetit të procesit dhe të llogaridhënies së të gjithë zyrtarëve, pse jo, për të gjetur prova për ndjekjen penale; kutitë le të hapen të gjitha pasi të ketë dalë rezultati zgjedhor. Kjo do t'i bëjë zyrtarët zgjedhorë shumë më të kujdesshëm për të parandaluar çdo shkelje, e cila nesër do të jetë e kontrollueshme, e auditueshme dhe natyrshëm ekspozon veprimet e çdo zyrtari në këtë proces.

Megjithatë, nuk dua të zgjatem, dua të falënderoj përfaqësuesit e misionëve që janë këtu, sepse na kanë dhënë një ndihmë shumë të çmuar në një punë të papërfunduar akoma!

Me zonjën Hajdari kam qenë në komunikim të vazhdueshëm dhe kemi pasur një frymë të mirë bashkëpunimi, ashtu siç dëshiroj ta kemi edhe me opozitën jashtëparlamentare, e cila kishte një vullnet të mirë në fillim, por me situatën e re mund të ketë ndonjë ndryshim, kjo do të duket, sepse nuk dua ta paragjykoj. Njerëzit nuk maten nga fjalët, por nga veprat.

Fjalën po ia jap zonjës Hajdari, para se t'ua japim ekspertëve, të cilët do të bëjnë një ekspozë dhe pastaj anëtarët mund të bëjnë pyetje, diskutime dhe sugjerime.

**Rudina Hajdari** – Mirëmëngjesi, kolegë!

Uroj të jeni mirë!

Besoj se zoti Gjijnuri e ezauroi të gjithë prezantimin e procesit deri më tani dhe propozimet që kanë ardhur nga opozita jashtëparlamentare. Ajo që është e rëndësishme për t'u theksuar është që kjo mbledhje, për sa i përket Komisionit të Posaçëm të Reformës

Zgjedhore, duhet të kishte ndodhur me kohë dhe ne duhet t'ju kishim mbajtur të informuar në lidhje me procesin, por ju e dini fare mirë që ishte një proces shumë delikat, sepse ne e kemi thënë që në krye të herës që procesi duhet të jetë gjithëpërfshirës, duhet të jetë i plotë, duhet të jetë i gjithëpranuar dhe duhet të prekë të gjitha hallkat e reformës zgjedhore, e cila ka zgjatur pafund.

Në këtë kohë është e nevojshme që Shqipëria të ketë një reformë zgjedhore, sepse ju e dini që sa herë që bëhen zgjedhje ne i kontestojmë ato. Në një vend demokratik, ku standarde të tilla janë vënë me zgjedhje të manipuluar, me zgjedhje ku vidhet vota apo me zgjedhje ku rezultati nuk pranohet, duhet me patjetër të ndryshojmë kushtet dhe procesin zgjedhor, por jo vetëm kaq, ne si përfaqësues të Kuvendit, me të drejta të plota si anëtarë, edhe ne si bashkëkryetarë, duhet të bashkëpunojmë që t'i shikojmë mirë parametrat dhe t'i shohim mirë kushtet, pra t'u garantojmë qytetarëve shqiptarë zbatimin e plotë të Kushtetutës dhe të drejtave që janë të mbrojtura në këtë Kushtetutë.

Ne si anëtarë të këtij komisioni kemi një detyrë madhore, e cila tashmë është e kushtezuar edhe nga Bashkimi Europian dhe duke qenë e tillë, ne e kemi si kusht jo vetëm ndaj tyre, por edhe ndaj qytetarëve shqiptarë për të pasur zgjedhje me standarde europiane dhe zgjedhje të lira e të barabarta për të gjithë.

Jo më kot e fillova duke shpjeguar rrethanat që ishin më parë dhe duke thënë që këshilli politik shërbeu për të qenë një tryezë, e cila uli palët dhe e kreu këtë mision duke e bërë procesin më gjithëpërfshirës, duke e futur edhe opozitën jashtëparlamentare, e cila përfaqëson një pjesë të elektoratit të zgjedhësve. Pra, ata duhen marrë parasysh, sepse janë parti politike me një peshë në elektorat.

Më vjen mirë që gjatë asaj periudhe ne morëm propozimet e tyre, i kemi në tryezë dhe nuk kemi humbur asgjë. Pra, siç e tha edhe zoti Gjijknuri, propozimet janë marrë për të gjitha pikat që kishim rënë dakord, me metodologjinë që këshilli politik ra dakrod. Ne pothuajse kemi pasur një dakordësi të përgjithshme, por jo të gjitha pikat e tyre janë pranuar, në kuptimin që do të shikohen dhe do të trajtohen edhe nga ekspertët, sepse do të jenë ata që do të na i shpjegojnë më hollësisht nëse janë të pranueshme.

Dua të theksoj se ky proces nuk ka mbaruar, e kemi deri në fund të qershorit dhe puna jonë është që të biem dakord me të gjitha pikat dhe të kuptojmë që ky proces është i dakordësuar edhe me opozitën jashtëparlamentare. Pra, jemi në etapën e fundit dhe do ta çojmë këtë proces deri në fund, por të mos harrojmë që reforma zgjedhore, pa dakordësinë tonë, nuk përfundon dot dhe për këtë ne të gjithë jemi të vetëdijshëm. Sistemi zgjedhor, siç e

tha edhe zoti Gjikhuri, është një nga ato propozimet e nxehta, që ne si opozitë parlamentare e kemi shpallur si kalin e betejës dhe kemi ecur para, sepse mendojmë fort që është një betejë e drejtë për qytetarët shqiptarë, sepse në kushtet ku jemi sot sistemi zgjedhor nuk na jep shanse të barabarta për t'u zgjedhur dhe nuk i jep parlamentit sovranitetin e duhur. Pra, nëse në Shqipëri do të kemi një demokraci më funksionale dhe më të përfaqësuar duhet të prekim sistemin zgjedhor.

Për sa u përket kushteve për ndryshimin e Kushtetutës, ne i kemi dhënë propozimet tona. Ato i kemi bërë bashkërisht me deputetët që janë të pranishëm këtu, të cilët i kanë bërë propozimet dhe i kanë depozituar në komision. Propozimet e tyre ne i kemi shqyrtuar edhe në këshillin politik. Ne kemi parë dy variante, në kuptimin që të ecim para, qoftë me ndryshimin e Kushtetutës, qoftë edhe me mosndryshimin e saj. Pra, akoma ka një dritë jeshile për sa i përket kësaj gjëje, sepse ne mund të shikojmë një proces, i cili mund të marrë parasysh edhe ndryshimin e sistemit, siç është hapja e listave pa prekur Kushtetutën, por për këtë fjalën e fundit dua t'ua lë ekspertëve për të na thënë se si mund të realizohet kjo pa humbur kohë, sepse dua që edhe ju, meqë nuk keni pasur mundësi të shpreheni, të shpreheni në komision dhe dua të falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit dhe ekspertët e pranishëm, që gjetën kohën për të qenë në këtë seancë.

**Damian Gjikhuri** – Së pari, përpara se t'ju jap fjalën me mirëkuptimin tuaj, dua të bëj të qartë se mbledhja është e brendshme, pavarësisht se është *online* dhe efekti i kamerës na krijon idenë se po na ndjekin edhe të tjerë, por është një mbledhje e mbyllur, pra nuk kemi ndjekje direkt nga mediet të kësaj mbledhjeje, duke i ndenjur besnik asaj procedure, që kemi vendosur që në fillim.

Së dyti, nëse do të ishit dakord dhe do të kishit pak durim, një nga ekspertët të bëjë një ekspozitë më të detajuar të disa çështjeve, pastaj fjala është e lirë.

Më mirëkuptoni, më mirë të vazhdojë eksperti, pastaj pjesa tjetër le të vazhdojë diskutimin.

**Viktor Gumi** – A mund të flas?

**Damian Gjikhuri** – Po.

**Viktor Gumi** – Faleminderit!

Në, në cilësinë e ekspertëve, në bazë të kërkesës, kemi përgatitur një memo, aq sa ishte e mundur për të detajuar, për informacion për komisionin e Reformës Zgjedhore të ngritur nga parlamenti, veprimtarinë dhe produktet që ka nxjerrë Këshilli Politik. Sikundër u theksua pak më parë, fillimisht është miratuar programi i punës në datën 27 janar, i cili

përmbante gjithsej 13 pika me çështje konkrete dhe me afate të përcaktuara për realizimin e tyre. Ka pasur disa ndryshime në lidhje me afatet, të cilat për shkak të nivelit punës nuk ishin reflektuar, por përgjithësisht programi i punës është ezauruar me përjashtim të një pike, që ka të bëjë me sistemin zgjedhor. Në datën 9 mars u bë prezantimi i tri nismave në Këshillin Politik për ndryshimin e sistemit dhe u vendos që diskutimi për këto çështje të bëhej në datën 13 mars, por fatkeqësisht ndodhi pandemia e COVID-19 dhe gjithçka, prej datës 10 mars, u ndërpre në këtë pikë.

Në lidhje me metodologjinë e punës në Këshillin Politik, ajo kishte të bënte, së pari, me prezantimin e të gjitha platformave, vendimeve dhe politikave, që gjykonin se duhej të ndiqeshin nga anëtarët e palëve politike në Këshillin Politik, zhvillohej diskutimi në parim i këtyre parimeve, apo formulimeve dhe ku gjendej konsensusi politik, ia reflektonin grupit të ekspertëve për trajtim.

Nga ana tjetër u zhvillua edhe një metodologji tjetër, që do të thotë se kur grupi i ekspertëve mblidhej dhe gjendej një natyrë e nivelit teknik, gjendej edhe konsensus mes palëve, kjo i refleктоhej edhe nivelit politik për ta informuar nëse ishte për zgjidhjen e konfliktit, ose të zbutjes së mosmarrëveshjeve, që mund të kishin lindur në kuadër të diskutimeve në Këshillin Politik.

Grupi i ekspertëve teknikë u ngrit me një vendim të veçantë të Këshillit Politik, ai përbëhej nga dy ekspertë që ishin pjesë e Komisionit për Reformën Zgjedhore, u caktua në cilësinë e dy bashkëkryetarëve nga një ekspert teknik nga secili grup dhe opozita jashtëparlamentare, terminologji që është përdorur në momentin e krijimit të Këshillit Politik, emëroi si anëtar të Këshillit Politik 4 ekspertë të saj në këtë grupim. Prej datës 11 shkurt deri në mes të marsit grupit të ekspertëve teknikë i janë atashuar edhe dy ekspertë të caktuar nga ODIHR-i, me të cilët ne si ekspertë teknikë, bashkë, ose veç, kemi pasur kontakte çdo 2-3 ditë dhe organizonim takime për diskutimin e çështjeve të veçanta të tyre. Në kuptimin formal grupi i ekspertëve të ODIHR-it ka prodhuar tri memo, dy kanë të bëjnë me materiale me shkrim, që u shpërndahen anëtarëve të Këshillit Politik dhe grupit të ekspertëve teknikë, dy kanë të bëjnë me respektimin e kuotës gender në Kodin Zgjedhor dhe memoja e tretë ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë në zgjedhje.

Për t'i rënë shkurt, se pjesa tjetër është e parashikuar në memon që ju kemi paraqitur, në lidhje me rezervën që mund të kenë disa çështje, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një proces draftimi, mund të ndryshohet një fjali, një presje, mund të shtohet, apo të hiqet një formulim i caktuar, ne vlerësojmë se është arritur konsensusi politik në 6 aspekte, që kanë të



bëjnë me legjislacionin mbi bazën e propozimeve të opozitës jashtëparlamentare, jashtë Kodit Zgjedhor.

Konkretisht besoj se kemi arritur konsensusin dhe këtë gjë ia kemi njoftuar edhe Këshillit Politik. Në grupin e ekspertëve teknikë janë 6 projektligje, njëri ka të bëjë me Kodin e Procedurës Penale, pra zgjerimin e juridiksionit që do të ketë Prokuroria e Posaçme edhe në çështjet e korrupsionit aktiv dhe pasiv në fushën e zgjedhjeve, dy kanë të bëjnë me disa ndryshime në Kodin Penal, saktësime që kanë të bëjnë me teknikën e shkrimit të dispozitave për korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje, si dhe bashkëpunimin dhe lehtësitë që i jepet bashkëpunëtorit, pra përjashtimi nga përgjegjësia penale në çështjet, kur ai bashkëpunon për efekt të procedimeve penale dhe ndëshkimeve në kuadër të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje.

Gjithashtu është bërë amendimi i ligjit “Për Policinë e Shtetit” mbi bazën e propozimeve që ka paraqitur opozita jashtëparlamentare në lidhje me rolin e policisë në zgjedhje. Për këtë gjë, së bashku me ligjin “Për prokurorinë e përgjithshme” i është kërkuar mendim zyrtar institucioneve shtetërore, të cilat e kanë paraqitur atë, iu është bërë me dije anëtarëve të grupit të ekspertëve teknikë për *(shkeputet zeri)* e këtyre institucioneve, i është nënshtuar diskutimeve dhe debatit brenda grupit të ekspertëve teknikë dhe gjykojmë që kemi arritur një konsensus në rolin e policisë nëpërmjet një ligji që ka të bëjë me ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe vlerësojmë se kemi kënaqur çdo kërkesë, që mund të jetë e vlefshme në këtë drejtim.

Mbi bazën e propozimeve të kësaj opozite jashtëparlamentare është bërë ndryshimi i ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, duke i dhënë statusin e sinjalizuesit dhe duke garantuar mbrojtjen ligjore kujtdo që paraqet një informacion në lidhje me çështjet e korrupsionit aktiv dhe pasiv dhe përgjithësisht çështje që kanë të bëjnë me vepra penale në fushën e zgjedhjeve është bërë, gjithashtu, ndryshimi përkatës në kuadër të një roli aktiv që duhet të ketë organi i prokurorisë në çështjen e hetimit dhe ndëshkimit, pastaj korrupsionit zgjedhor, konkretisht nëpërmjet amendamenteve konkrete, që janë bërë në lidhje me statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”. Për këto pika mund të ketë një këndvështrim më të fortë ose më të dobët në lidhje me ndonjë nen të caktuar, por gjykojmë se në këtë pikë e kemi gjetur konsensusin. Baza pothuajse ka rënë dakord me grupin e ekspertëve teknikë dhe çështja e draftimit është një proces, i cili mund të vazhdojë, sepse i tillë është draftimi, ku një

fjalie të rishkruar mund t'i rikthehemi për ta përmirësuar, por vlerësojmë se janë lehtësisht të zgjidhshme dhe pothuajse munda ta konsiderojmë si punë të përfunduar.

Në lidhje me pikat e tjera, përgjithësisht ka pasur konsensus për dy aspekte, që është arritur nga grupi i ekspertëve teknikë.

Së pari, e përmenda, zoti bashkëkryetar, çështjen e financimit të zgjedhjeve, ku kontribut të vlefshëm dhe të çmuar ka dhënë NDI-ja me ekspertizën e saj, ku gjatë gjithë kësaj kohe ka paraqitur opinione dhe informacione të vlefshme për anëtarët e grupit të ekspertëve, por, besoj gjithashtu, edhe për deputetët dhe anëtarët e Këshillit Politik. Pra, është rënë dakord që financimi i zgjedhjeve do të vazhdojë me amendimet përkatëse dhe mbështetur në draftin e organizuar dhe të paraqitur nga një projekt i Këshillit të Europës. Kjo do të ngelet si kapitull i veçantë i Kodit Zgjedhor në fuqi, me rezervën, ku pothuajse të gjithë anëtarët e grupit të ekspertëve teknikë kanë rënë dakord, që në një të ardhme duhet të fillojë puna për miratimin e një ligji të ri organik, i cili të rregullojë çështjet e financimit të partive politike në periudhën e tyre normale, ashtu siç do të jetë edhe në periudhat e tyre zgjedhore dhe, njëkohësisht, mekanizmit të monitorimit dhe mbikëqyrjes më të fortë të këtyre financimeve të partive politike.

Së dyti, aspekti tjetër, ku konkludojmë se është rënë dakord me grupin e ekspertëve teknikë, është që për shkak të amendimeve, që ka pësuar Kodi Zgjedhor, tashmë, me matematikë, ngelemi në 3 ose 4 dispozita, të cilat nuk janë prekur dhe, nga ana tjetër, kemi edhe ndryshimet e bazave fundamentale, të themeleve të Kodit Zgjedhor, siç është rasti i administratës zgjedhore ose çështje të tjera. Pra, bën më shumë sens të kemi një ligj të ri integral për zgjedhjet e përgjithshme, zgjedhjet vendore, sesa të vijojmë me amendime për të cilat, në fund të ditës, edhe nga kriteri sasior, kur të mblidhen dispozitat, do të ngelen vetëm 3 ose 4 nene të Kodit Zgjedhor, që nuk kanë ndryshuar. Prandaj edhe për këtë pikë është gjetur një konsensus në grupin e ekspertëve teknikë.

Në këtë periudhë pandemie unë dhe zoti Rusmali kemi punuar lidhur me draftin integral të këtij projektligji të ri, kemi *inseft*-uar në të gjithë konsensusin që është realizuar dhe, në kuadër të draftimit të ligjit të ri integral, besoj se është një proces, i cili do të vijojë dhe është afër fundit.

Dy janë çështjet, të cilat kanë mbetur në pikëpyetje, siç ju e përmendet pak më parë, për të cilat ne vlerësojmë se ka një sensibilitet të veçantë.

Çështja e parë ka të bëjë me çështjet e administrimit zgjedhor në 3 nivelet e tij. Aktualisht, propozimin nga opozita jashtëparlamentare dhe diskutimin në Këshill e kemi

vendosur për dy nivele, për nivelin e Komisionit të Qendrës së Votimit dhe për nivelin e KZAZ-së, nivelit të dytë të administratës zgjedhore, sepse nuk kemi material për KQZ-në, për nivelin e tretë të administratës zgjedhore.

Çështja e dytë ka të bëjë me kompozimin dhe funksionimin e Kolegjit Zgjedhor. Në lidhje me Kolegjin Zgjedhor, ky ka qenë debat dhe diskutim i gjerë në grupin e ekspertëve teknikë, por është arritur një konsensus që Kolegji Zgjedhor do të jetë institucion tranzitor deri në një periudhë të caktuar kohore, pastaj çështja duhet t'i shtrohet normalitetit të saj dhe është pranuar që kompetencat në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative t'i ketë Gjykata Administrative e Apelit. Ndërkohë, sipas problemit tonë, që është diskutuar edhe në Komisionin e Posaçëm të reformës Zgjedhore, është vendosur që deri në mbylljen e procesit të afatit ligjor të vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të vijojë të qëndrojë në detyrë Kolegji Zgjedhor aktual, në formulën aktuale që ekziston, por duke zgjeruar pullin e gjyqtarëve, prej të cilëve do të zgjidhet ky Kolegj Zgjedhor. Ka pasur diskutime dhe këndvështrime të ndryshme lidhur me imunitetin dhe procedurën se si duhet të zgjidhen anëtarët e Kolegjit Zgjedhor. Ne, duke pasur luksin dhe mundësinë të marrim pjesë në diskutimin e këshillit politik dhe në grupin e ekspertëve teknikë, kemi pasur mundësinë të dëgjojmë të gjitha këndvështrimet e palëve dhe, mbi bazën e disa instruksioneve të dhëna dhe detyrave të lëna nga këshilli politik, jemi përpjekur të gjejmë dhe të eksplorojmë një mundësi konsensusi, duke dëgjuar të gjitha pretendimet e palëve, aq sa mund të bëjmë ne, palët e një niveli teknik, për t'ua propozuar palëve.

Në këtë këndvështrim, edhe për Kolegjin Zgjedhor, edhe për çështjen e administratës zgjedhore, ne kemi përpunuar disa drafte, disa amendamente të neneve konkrete, të cilat janë materiali i parë bruto për të diskutuar politikisht në nivelin politik dhe në planin politik përmbajtjen e tyre, pastaj, në rast dakordësimi, sipas diskutimit dhe vendimmarrjes politike në këtë drejtim, të vijohet më tej me amendime më konkrete, ndryshime apo rrëzime të tyre.

Një aspekt të fundit, që ju e përmendet, zoti Kryetar, në mbledhjen e fundit të këshillit politik, në mbledhjen e datës 9, ai vendosi tri gjëra: të kërkojë informacion në lidhje me praktikën e disa vendeve të tjera europiane dhe në rajon për çështje të financimit, ku, në dijeninë tonë, NDI-ja ka përgatitur dhe ka shpërndarë një material lidhur me praktikën e vendeve europiane dhe vendeve në Ballkan për çështje të financimit të zgjedhjeve; na u kërkua neve, në cilësinë e ekspertëve teknikë, mua dhe zotit Rusmalit, të paraqesim mendim për dy pyetje, pra, jo për çështje të përmbajtjes, por më tepër për aspekte të procedurës, ku pyetja e parë ishte nëse propozimet e paraqitura për çështjet e sistemit kishin apo jo

implikime të një natyre kushtetuese dhe kërkesa e dytë ishte të paraqesim praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare, që eventualisht duhet të ndiqen nga Kuvendi i Shqipërisë në rast se do të ndryshohet sistemi zgjedhor. Për këto ne e kemi pothuajse gati materialin për ta paraqitur dhe ju do ta gjykoni se ku do ta paraqesim, në këshillin e posaçëm apo në këshillin politik. Ne jemi të gatshëm të mbrojmë idetë tona në lidhje me to.

Më tej, gjithçka është shkruar me detaje. Besoj se ka pasur një frymë kompromisi. Për këshillin politik ne nuk mund të themi gjë, por në rastin e këshillit të ekspertëve teknikë, dua të them se ka qenë përgjithësisht një kompromis për bashkëpunimin total midis palëve. Ekspertët e ODIHR-it kanë qenë prezentë në çdo mbledhje të këshillit të ekspertëve teknikë. Ne kemi qenë bashkërisht në zyrën e tyre për t'i diskutuar çështje qoftë veç e veç, qoftë së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të ekspertëve teknikë. Ne kemi bërë maksimumin tonë të mundshëm brenda këtij afatin kohor për t'i realizuar këto gjëra që ju paraqitëm.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Pas ekspozesë që bëri zoti Gumi, mendoj dhe dëshiroj që çështjet, pyetjet dhe ndonjë diskutim të fokusohen te këto që folëm.

E thashë edhe më parë, por dua ta them edhe një herë: këshilli politik duhet ta kryejë punën e tij në një periudhë shumë të shkurtër, sepse, kur themi qershorin e vitit 2020, për sa i përket afatit për të miratuar Kodin, do të thotë që komision ta ketë përfunduar punën.

Qëllimi është, unë e kam thënë publikisht dhe po e përsëris, dhe ua kam kërkuar të gjithë aktorëve me të cilët kam folur, që brenda muajit maj ne t'i mbyllim të gjitha çështjet e mbetura të diskutueshme me opozitën jashtëparlamentare. Më pas çështja do të vazhdojë në Komisionin e Reformës Zgjedhore, më pas në Kuvend për t'u miratuar, në qoftë se do të kemi konsensus për çështjet të cilat do t'i ngrini këtu për sa i përket sistemit. Por që të mos keqkuptohemi, nuk është se do të presim deri në fund qershorin, kërkojmë nga opozita që ato pak ditë që mbeten, për shkak të pandemisë, qoftë edhe një javë apo dy javë më shumë, ne mund t'i kompensojmë në muajin maj. Realisht, do t'i drejtohem zyrtarisht opozitës, në mënyrë që të rifillojmë edhe një herë punën për të parë edhe vullnetet e tyre, në të kundërt pastaj ne si komision jemi të detyruar ta vazhdojmë punën tonë, pasi nuk mund ta mbajmë peng këtë proces. Ata thonë se i kanë sjellë kërkesat e tyre, një pjesë e kërkesave, ashtu siç e tha edhe zoti Viktor, janë përfshirë. Për çështje që kemi në debat, natyrisht na mbetet që t'i drejtohem ODIHR-it për të dhëna opinionet në lidhje me alternativat e mundshme të zgjidhjes.

Fjalën e ka kërkuar zoti Murrizi, por do ta bëjmë me radhë, një nga maxhoranca dhe një nga opozita.

Urdhëroni, zoti Murrizi!

**Myslim Murrizi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, meqenëse në fillim të fjalës suaj thatë nuk ka kamera dhe medie, ju tërheq miqësisht vëmendjen që jo të gjithë jemi hipokritë njëlloj, që ndryshe flasim para kamerave dhe ndryshe skutave. Për mua nuk ka asnjë lloj problemi, por besoj se edhe për një pjesë të mirë të kolegëve të opozitës, nëse ka apo jo kamerave. Ne kemi ardhur të diskutojmë me njëri-tjetrin dhe këto që do të themi këtu nuk më pengon asgjë t'i them para çdolloj kamere, ku do që të jetë ajo.

Hipokrizia e dyftyrësisë që, ndryshe flasim para kamerave dhe ndryshe veprojmë, është e atyre që prej 30 vjetësh, qofshin shqiptarë apo ndërkombëtarë, kanë luajtur teatër në kurriz të shqiptarëve. Unë nuk bëj pjesë tek ajo kategori, besoj se edhe kolegë të tjerë me integritet, edhe të PS-së, nuk bëjmë pjesë te politikanët hipokritë që, ndryshe flasin para kamerave, ndryshe pas kamerave.

Së dyti, dua të di në kulturën time juridike të eksperiencës së marrë me politikë, si herë e dytë në Kuvend: çfarë është këshilli politik?! Nuk e gjej as në Kushtetutë, as në ligj dhe as në Rregulloren e Kuvendit. Me vendim të cilit institucioni kushtetues është ngritur ky?! Është i ngjashëm me bandat e '97-ës dhe komitetet e Jugut?! Është pushtet paralel si sovjeti suprem?! E kanë ngritur këta që paguhën këtu, të cilët mbushin trastat dhe ikin, apo është një skuth i asaj që lançove në fillim të fjalës sate që nuk ka kamera?! Unë nuk e njoh fare si organ, sikurse jam i hapur absolutisht me Bashën të parin, edhe me sivëllain tënd Oerdin, edhe Peçi Vasilin, që të vijnë dhe të ulen së bashku me ne në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe i lëmë ata të flasin sa të kenë takat dhe, në qoftë se na bindin për ato që thonë, në të drejtën edhe të asaj që ne kemi kërkuar, i votojmë me kënaqësi dhe të vijnë te ne. Ne as nuk jemi vrarë dhe as nuk jemi prerë me ta! Kryeministri ynë ka përqaftuar dhe po puthet me kryeministrin serb, edhe me grekun, kurse Izraeli rroket në qafë me gjermanin! Çfarë kemi ne? As unë, as Rudina nuk besoj se jemi vrarë me Bashën; nuk besoj as ti, megjithëse të tha se do të vrasë, por nuk të vrau, të uli në sofër; edhe me Peçin, jo e jo, se nuk e njoh fare as si doktor dhe as si infermier, kështu që, bujrrëm, le të vijnë në komision!

Çfarë ka shtyrë Kuvendi deri më 30 qershor, këshillin politik apo mandatin e këtij komisioni? Kuvendi nuk ka lajthitur nga trutë e kokës që të bëjë akte ligjore apo të nxjerrë vendime për organe që nuk ekzistojnë fare në asnjë cep të gjithë legjislacionit shqiptar?! Të

gjitha detajet teknike që ju thatë (nuk e di pse e keni shtyrë deri më 30 qershor) që rregullojnë mbarëvajtjen e procesit, jo shto ujë dhe shto miell, si administratat zgjedhore jomilitante dhe jo nga partitë, një numërim elektronik, sepse ndoshta votimi nuk bëhet, dhe të ndajmë çfarë vullneti kemi, pra do të japim dritë jeshile që të votojnë emigrantë apo jo, janë thelbi, përveç sistemit, që është shtylla kurrizore e të gjithë asaj që ne jemi ngritur si komision. Pra, hajdeni t'i kalojmë të enjten tjetër, më pas pjesa tjetër se nga do t'i gjejmë lekët, sepse ju vetëm te lekët ju shkon mendja edheje, edhe Bashës... Çfarë sikleti keni me lekët?! Nuk besoj se do të duhet kaq shumë punë që shty e shty. Ka filluar që më shtator të vitit 2017 dhe, për turpin e parlamenti dhe të atyre që bëjnë ciu-ciu nëpër bunkerët e Pallatit të Kongreseve, nuk është bërë asgjë prej 3 vjetësh.

Që mos ta marr fjalën dy herë, dua të ndalem për ju, kolegë, ashtu siç e kemi thënë herë tjetër, por edhe për të gjithë këta bilbilfryrësit, vëzhguesit që i paskeni sanksionuar me ligj (nuk e di për këta ndërkombëtarët e keni fjalën, pra për këta sinjalizuesit e keni fjalën) nuk besoj se Shqipëria ka ceduar nga spiunllëku i sinjalizuesve, qofshin këta të huaj apo të brendshëm. Në 45 vjet kemi pasur 156 mijë spiunë. Unë dhe 20 kolegë të tjerë kemi bërë ligj enkas, i cili do të vijë në parlament për t'i qeruar nga politika të gjithë spiunët e këtij vendi së bashku me ata që i kanë rekrutuar si spiunë. Këta ndërkombëtarët, nuk e di, janë bilbilfryrës?!

Ndryshimet kushtetuese të 21 prillit të vitit 2008, nuk e di ke qenë ti Damian, apo jo, kur ky garanti i Kushtetutës theu vazot e luleve e hyri në grevë urie, kanë vrarë demokracinë. Shqiptarët prej 3 palë zgjedhjesh nuk zgjedhin, por thjesht votojnë si në 45 vjet në komunizëm. Këta bilbilfryrësit ndërkombëtarë i kanë këtu. 28 vendet e këtyre bilbilfryrësve të BE-së, jo ato matanë oqeanit, nuk kanë këtë sistem bastard që kemi ne. Të na sjellin një sistem, sepse këta ndërhykan te financimi, ndërhykan te rregulli i partisë, ndërhykan se çfarë ngjyre duhet të kenë sytë e komisionerit që do të numërojë, dhe nuk ndërhyjnë te thelbi, që është vrarë demokracia! Një nga këta bilbilfryrësit, që ti ke thirrur sot në mbledhje, të marrë një nga ligjet e vendeve të veta, unë nuk besoj të jenë rumunë ose bullgarë këta bilbilfryrës, se vetëm ata e kanë këtë sistem, sepse vijnë nga kooperativat, nga komunizmi, të na sjellin një sistem të tyre dhe hajdeni ta votojmë të enjten tjetër. Pse i lodhni këto? Edhe bilbilfryrësit e brendshëm duhet të paguhen. Këta bilbilfryrësit e huaj paguhen nga taksat e qytetarëve të tyre. Ta vendosë këshilli politik, thotë specialisti... *(Nuk dëgjohet)*

Damian, a më dëgjon?

**Damian Gjikhuri** – Tani po.

**Myslim Murrizi** – Pra, specialisti thotë ta vendosë këshilli politik që të merret një grup ekspertësh. Këshilli politik është një organ në hava për vete, si paska tagër të sanksionojë, të bëjë nënbashkësi të havave të tjera?! Në Këshillin politik që keni firmosur jeni ti, Peçi dhe shoku yt, Oerdi. Nuk di Partia Demokratike, as Peçi, që thua ti kanë folur në televizor, pra ajo pjesa e kamerave që përmende zotrote, flasin që t'i dëgjojnë miletit se edhe këta e duan ndryshimin e sistemit, por nuk sjellin letrat, sepse u dridhen leqet e këmbëve nga zullumet që kanë në kurriz në qeverisjet e viteve 2005-2013 dhe 2013-2017 me ju, ai Peçja i famshëm, për të shkuar te qytetarët dhe për t'u kërkuar votë qytetarëve!

Ndaj, para se të kalojmë në buzëkuqe, edhe emrin ia bëjmë të madh "reforma zgjedhore", ndërkohë në historinë 30-vjeçare postkomuniste asnjë reformë në vend, qoftë ajo e drejtësisë, që para pak vitesh e kalove, ke votuar edhe zotrote, nuk bëhet me arnime, duhet prekur thelbi. Nuk mund të quhet reformë, nëse nuk preket thelbi që është shkelur më 21 prill të viti 2008, pra ndryshimi i sistemit zgjedhor, ose mazhoritar me qarqe, ose me lista të hapura, në rang kombëtar, por t'ua afrojmë këtë mundësi shqiptarëve, të cilët para 30 vjetësh u ngritën në revoltë kundër komunizmit dhe aspiruan që të ketë vlerë vota. Ua kemi hequr të drejtën e votës qytetarëve shqiptarë, i kemi kthyer thjesht në votues. Po prekëm thelbin, ajo është reformë. Arnimet e kodit, që thoni ju, janë buzëkuqe. Unë nuk emocionohem nga buzëkuqet e Boshardit, pse ai kërkon ta paraqesë si sukses para Ramës, sepse është punëtor i Ramës këtë vit, apo ta paraqesë si sukses para Ditmirit, sepse më duket se varet nga Ditmiri, këtë ka caktuar ai për Boshardin, dhe të vuajmë në kurriz një neokomunizëm të ri, 30 vjet pasi rrëzuan komunizmin e egër dhe diktatorial. Jo, zotëri, mos u tallni me shqiptarët!

Pse e quani kaq herezi prekjen e Kushtetutës?! Ju e keni prekur Kushtetutën për OFL-në. E prekët para disa ditësh, kur vendosët që anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të betohen te noteri, te parukieri buzë Lanës. Çfarë herezie ka? Ju e keni dakordësinë me pash për të prekur Kushtetutën në funksion të rritjes së demokracisë së qytetarëve shqiptarë. 94 vota ju po i merrni për t'i dhënë Çetit koncesion! U keni futur karamele në fyt disa deputetëve pseudoopozitarë dhe i mbani atje. Çfarë problemi ka Kushtetuta?! Keni hall se është e shenjtë dhe është miratuar në vitin 1998 me gjeneral Imamin? Ishte Zan Çausi që drejtonte Imamin dhe nga kjo e keni problem Kushtetutën? E shkeli Berisha me Ramën, i vunë shkelmin në fyt në prill të vitit 2008. Hajdeni të diskutojmë, të vijmë edhe ata, por të vijmë në institucion! Në vitin 1997, kur gjysma e Shqipërisë kishte rënë nën goditjen e armëve të bandave, është bërë në Presidencë. Të vijmë në komision! Edhe ne po kërkojmë njëri-tjetrin në seancë, ti na mban këtu në televizor 12 veta. Na mblidh, o vëlla, te salla, ta shohim njëri-tjetrin në sy, se

nuk besoj se na gjen gjë nga koronavirusi! Ka thënë sekretari i shtetit që është virus laboratorik.

**Damian Gjikhuri**- Unë kam hallin tuaj, por dakord jam.

**Myslim Murrizi**- Ti ke hallin tënd, por a e di kush e ka hallin më të madh, Damian? E kanë ata që kanë lekë më shumë, se iu dhimbset jeta.

**Damian Gjikhuri**- Ti, pra.

**Myslim Murrizi**- Por unë i kam të miat, kjo është diferenca. Unë fle gjumë rehat dhe i prish sipas qejfit, pa u fshehur as nga bilbilfryrësit e huaj, as nga këta të vendit.

Kështu që, Damian, na mblidh pak më afër, nuk është ndonjë problem i madh, ne jemi 12 anëtarë të reformës dhe mblidhi të gjithë bilbilfryrësit tuaj. Na mblidh te salla e seancave, ku ka vend edhe për bilbilfryrësit sa të duash, për bilbilfryrësit që vijnë për të mbrojtur interesin e demokracisë në Shqipëri dhe që duan që shqiptarët të ushtrojnë demokracinë e votës.

Prandaj, të gjitha detajet teknike që përmendi zoti Gumi...

**Damian Gjikhuri** - Ju lutem, zoti Murrizi, përmbliidheni fjalën!

**Myslim Murrizi** – Po, dakord, se nuk flas më.

Nga të gjitha detajet teknike që përmendi zoti Gumi, unë nuk kuptova se përse tha financimi i zgjedhjeve. A është financimi i fushatës apo i zgjedhjeve? Sepse zgjedhjet i financon KQZ-ja. Pra, për çfarë financimi e kishte fjalën?

**Damian Gjikhuri** - Për financimin e fushatës e ka pasur fjalën.

**Myslim Murrizi** - Unë mbajtja shënime, kur foli specialisti dhe ai tha financimi i zgjedhjeve.

**Damian Gjikhuri** - Ka bërë lapsus.

**Myslim Murrizi** – Tani sa i përket këshillit politik, se ti je këtu, edhe Rudina është këtu, ta ndryshoni emrin ju të dy, bashkëkryetarët e komisionit, që keni marrë legjitimitetin e një parlamenti me 122 deputetë, dhe ju përgëzoj, që jua njohu edhe gardiani i Kushtetutës para një jave, ai roja, që firmosi ndryshimin e Kodit Penal, dhe të shkon, të zvogëloheni dhe të hyni në prehër të Peçit dhe Oerdit, nuk shkon! Edhe me rregullat e përgjithshme, kanunore, zakonore ose të demokracisë së hershme pakica shkon te shumica. Ne jemi 14 veta, ndërsa ata janë dy, le të vijnë ata, bujrum, nuk paskan ardhur të gjithë ata që janë jashtë..! Le të vijnë në komision!

**Damian Gjikhuri**– Kanë frikë nga ty, mbase, nuk e di.



**Myslim Murrizi**- Jo, Damian, por duke qenë unë aty, nuk bëjnë muhabet me ty siç bëjnë kur nuk jam unë.

**Adnor Shameti** – Edhe unë me Myslimin jam...

**Myslim Murrizi** - Kështu që, zoti Gjiknuri, ftoji ata të vijnë në komision. Jam dakord. Nëse vijnë ata në komision, të jesh i bindur se do të mbaj qëndrim më të butë, nga sa po them, por mos i tremb.

**Adnor Shameti** – Po harxhojnë naftë ata, pse të bëjnë dy takime, Myslim?

**Myslim Murrizi**- Po naftë kanë 30 vjet qe vjedhin ata.

Ky është propozimi im, zoti Gjiknuri. Ftoji në emër të komisionit që nesër ose pasnesër. Gjeni një sallë më të madhe, të vijnë këtu dhe mos u mblidhni kot skutave, se po ta garantoj që do të lloj fort me të gjithë deputetët e opozitës, të gjithë ata që nuk e kanë lakun në fyt, pa pyetur për asnjë bilbilfryrës, të rrëzojnë çfarëdo hipokrizie që ju kërkoni të bëni te shqiptarët me këtë palaço Kod Zgjedhor!

Viktori, me të drejtë, tha të bëjmë një ligj të ri. Bëje, Viktor! Merr një ligj nga këta të bilbilfryrësve që ka ftuar Damiani, me inicialet “SHZHKPI” a çfarë ishin ato, dhe ejani ta votojmë të enjten tjetër! Nesër java e votoj unë i pari, mjafton që të shkojë e drejta tek i zoti i punës, që në këtë mes është qytetari shqiptar. Mendojeni çfarë do të bëjmë me emigrantët. Do t'ua japim edhe atyre të drejtën e votës? Pyeteni dhe Oerdin!

Pra, unë nuk e njoh Këshillin Politik, se është organ si komitetet e Zan Caushit. Keni qejf ta jepni, jepeni!

Deputetët e PD-së apo ish-deputetët, që kanë qejf të vijnë në komision, ftojini, zotërinj, të vijmë edhe ne dhe të marrim mend nga ata! Unë kam shumë nevojë për mendtë e Oerdit dhe të Peçit...

**Damian Gjiknuri** - Zoti Murrizi, faleminderit shumë!

Mendimet e tua janë shumë të vyera! Ke një stil të veçantë të të thënit të gjërave, që na argëton të gjithëve!

**Myslim Murrizi** - Ftoji, po të them sinqerisht, se unë kam shumë nevojë për eksperiencën e Peçit dhe të Oerdit te Kodi Zgjedhor! Ti i njeh, se ke qendruar me ata. Unë kam qejf t'i dëgjoj.

**Damian Gjiknuri** – Faleminderit!

Dua të jap nja dy shpjegime, meqë i ngriti zoti Murrizi.

Së pari, pavarësisht se jemi *online*, duhet të jemi të kujdesshëm me disa shprehje. Nuk është mirë të ofendojmë apo të flasim keq për përfaqësuesit e miqve tanë, të organizatave të

nderuara, pavarësisht nga kombësitë nga të cilat vijnë, që, për mendimin tim, janë të gjitha të nderuara...

**Myslim Murrizi** - Ka ikur koha që kush shante Kinën dhe Bashkimin Sovjetik, bëhej armik, Damian!

**Damian Gjikhuri** – ...janë miqtë e Shqipërisë, janë kombe-miq tanët! Janë njerëz që kanë eksperiencë shumë të mirë profesionale dhe na bëjnë nder me asistencën që na japin në këtë komision!

Së dyti, dua të theksoj që Këshilli Politik nuk është një organ i bazuar në Kushtetutë, por është një organ konsultativ politik. Ju e dini, e kemi thënë me kohë, që ligji zgjedhor është mbi të gjitha politik dhe nuk është si çdo ligj tjetër. Është ligji më i vështirë, më i komplikuar, për një arsye: jo se është i vështirë për t'u bërë, por është e vështirë për të gjetur konsensusin politik. Nuk është si ligjet e tjera, kur qeveria sjell një projektligj, mund të bëjnë diskutime deputetët, por vullneti shkon para dhe normalisht ligji nuk tretet rrugës, këtu procesi është më i vështirë, më i komplikuar, aq më tepër kur kemi një realitet të ri politik, ku një forcë ose disa forca të konsiderueshme kanë zgjedhur të mos jenë në Kuvend për fajet e tyre. Ky nuk është faji ynë, por, gjithsesi, ne duhet t'i marrim parasysh, sepse kjo ka qenë fryma, kjo është e mira e Shqipërisë, ky është edhe angazhimi që kemi marrë përballë aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë, të cilët na qëndrojnë si miq të mirë për të na ndihmuar në proceset tona integrale.

Kështu që, ju lutem, mos t'i kthehemi kësaj pike!

Unë ju kuptoj, ndoshta edhe unë do ta kisha shumë të thjeshtë të ulesha me ty a me ndonjë tjetër dhe ta bënim këtë ligj, por procesi është i tillë. Do të jetojmë me këtë vështirësi dhe jam i bindur që do t'ia dalim.

Nga ana tjetër, mos më keqkuptoni, por kur thashë 30 qershor, dua që çështjet me Këshillin Politik t'i mbyllim brenda muajit maj. Arsyeja pse ju mblodha si komision, së pari, është jo vetëm për informim, por dua të kem edhe vullnetin tuaj.

Që të na mirëkuptoni, ky është një kanal komunikimi mes Komisionit të Reformës Zgjedhore dhe opozitës, e cila është jashtë parlamentit, që ne e kemi pranuar tashmë si zgjidhje.

E mira është që ata të vinin këtu, por nuk vijnë. Ne e bëmë këtë hap bashkëpunues, këtë hap tolerues, këtë kompromis. Në fund të fundit, i madhi edhe ofron kompromis në këtë drejtim dhe nuk besoj se është ndonjë gjë e madhe.

Unë jam njeri praktik, edhe ti, Myslim, je i tillë, të gjithë duhet të jenë. Nuk ka rëndësi mënyra si flet, e rëndësishme është të kemi një produkt të duhur, i cili nesër të marrë votat e këtij parlamenti në ato numra që kërkon Kushtetuta. Aty pastaj do të negociosh ti, do të negociojë zonja në krah, do të thoni që nuk jemi dakord, sepse kërkojmë sistemin e të tjera, kjo është çështje që mbetet hapi tjetër. Çështja e sistemit është një çështje e shtruar për zgjidhje dhe diskutim dhe natyrshëm që kërkon kompromis.

Kur Viktori Viktori tha “ligji i ri zgjedhor”, e tha për arsye se ne po ndërhyjmë në 90% të neneve dhe është më mirë që të rishkruhet një ligj nga e para, që të mos ketë më shumë ndërhyrje. Për mua, e them me bindje këtë, në qoftë se ka një *game changer*, ka një gjë që do të ndryshojë.

Lidhur me mënyrën se si do të administrohen zgjedhjet, mendoj se është propozim i guximshëm. Edhe unë në fillim kam qenë disi skeptik. Mënyra se si është konceptuar administrata zgjedhore, një administratë e pavarur, që përgjigjet te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që zgjidhet rastësisht, janë njerëz që mbajnë përgjegjësi ligjore, por mbi të gjitha janë njerëz që raportojnë në linjën qendrore të komunikimit nga poshtë-lart për sa i përket administratës dhe nuk varen në hierarki nga partitë politike. Pra, kanë linjën e hierarkisë zyrtare për administrimin zgjedhor.

Ky do të jetë një ndryshim shumë i madh, pasi ne e dimë që partitë politike kanë qenë ato që shpeshherë urdhëronin komisionerët me telefona, krijojnë probleme në qendra votimi dhe zgjedhjet shqiptare shëmtoheshin atëherë kur vullneti i partive politike nuk ishte për të bërë zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Për të mos përsëritur, në qoftë se ka ndonjë anëtar nga ana e maxhorancës për të dhënë ndonjë mendim apo për të bërë pyetje, jeni të lutur të merrni fjalën.

Atëherë, do të vazhdojmë me zotin Gjoni.

**Ralf Gjoni** – Faleminderit!

Së pari, dua të falënderoj të dy bashkëkryetarët që mblodhën komisionin, i cili duhet të ishte mbledhur me kohë!

Në fakt, edhe unë jam shumë dakord ndaj shumicës së mendimeve të zotit Murrizi, që komisioni zyrtar legjitim është ky, dhe jo Këshilli Politik. Më duhet ta theksoj që Këshilli Politik, pavarësisht se ne i dhamë shansin të punonte, në emër të një bashkëpunimi politik gjithëpërfshirës me të gjitha palët, është kthyer në një kosh lodrash për të krijuar fabula, përralla dhe alibi për rehabilitimin e figurave të vjetra, të djegura në politikë.

Damian, Rudina, më lejoni t'ju drejtohem me emër, ju e dini shumë mirë që as kolegët e nderuar të maxhorancës dhe as ne si përfaqësues të opozitës në këtë komision, nuk jemi thjesht lojtarë të një fabule për të kënaqur tekat infantile të Partisë Demokratike apo të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Unë mendoj që ndoshta edhe me ndihmën e krizës së Koronës që na ka kthjelluar pak mendimet dhe qartësuar ujin e trurit, na ka dhënë një dozë vërtetësie, të cilën besoj se duhet ta ruajmë gjatë muajve në vazhdim dhe të fillojmë të flasim hapur, më hapur se ç'kemi folur më përpara, si me njëri-tjetrin, ashtu edhe me ata jashtë parlamentit, me ata aktorë politikë, të cilët vendosën ta braktisnin këtë parlament, ta dhunonin parlamentin dhe të kërcënonin me shkatërrimin e tij.

Si anëtarë të opozitës dhe si deputetë kemi detyrimin të ruajmë legjitimitetin dhe seriozitetin e institucionit të parlamentit dhe të institucionit të Komisionit të Reformës Zgjedhore, i cili është motori dhe gjeneratori i propozimeve, i trajtimit, i diskutimeve dhe i miratimit, përpara se të dërgohet në seancë plenare, të çdo lloj propozimi për ndryshimin e Kodit Zgjedhor.

Të lutem, Damian, nuk mundet që shqiptarët të besojnë se zgjidhja e ngërçit politik, që thelbin, thembrën e Akilit e ka te reforma zgjedhore, pasi gjatë këtyre 10 vjetëve për çdo krizë politike, ti e di më mirë sesa unë, problem kryesor ka qenë mungesa e besueshmërisë të institucionit të zgjedhjeve, nuk mundet që ne t'u hedhim hi syve shqiptarëve, me apo pa bekimin ndërkombëtar, se Tit Vasili dhe Oerd Bylykbashi qenkan përgjigjja e alternativës që i duhet këtij vendi për të dalë nga krizat e njëpasnjëshme të këtyre 10 vjetëve. Kjo me të vërtetë është një tallje me inteligjencën minimale që mund të ketë një deputet i Republikës së Shqipërisë. Mendoj se çdo propozim në këtë komision duhet të merret parasysh. Jam dakord me ju, Damian, edhe me zonjën Rudina, që nëse ata nuk vijnë më në Këshillin Politik, ne duhet të vazhdojmë dhe t'u japim drejtim gjërave në Komisionin e Reformës Zgjedhore.

Për sa kohë që Këshilli Politik po trajtohet si kosh lodrash për fëmijë, sepse kështu e kanë degraduar Këshillin Politik, mendoj se duhet të dalim më konkretisht te propozimet që ne kemi sjellë pranë këtij komisioni. Unë mendoj se po flas personalisht për veten time. Më lejo Myslim të flas edhe në emrin tënd, por edhe në emër të kolegëve të nderuar opozitarë, deputetë që kanë propozuar, pasi jemi disa deputetë që kemi propozuar zyrtarisht platforma dhe projektligje për të amenduar Kodin Zgjedhor. Besoj se ajo që ka bërë zoti Murrizi, ajo që kam bërë unë apo kolegët e tjerë, miqtë e mi të opozitës dhe miqtë tuaj, gjithashtu, meriton një lloj serioziteti, ndërkohë që të vetmet propozime serioze që janë bërë pranë këtij komisioni nuk kanë marrë asnjë vëmendje serioze, asnjë përgjigje dhe asnjë trajtim, përveçse

një fjalie që thotë Damiani, ku u është kërkuar ekspertëve të shohin nëse është kushtetuese apo jo.

E para, dalëngadalë po vijmë në fund të majit dhe propozimi im deri para 2 javësh nuk ishte *online*, sa për dijeni, as ekspertët e huaj që donin t'i hidhnin një sy nuk e gjenin dot, kështu që m'u desh t'i kërkoja administratës së Kuvendit ta vendoste *online* propozimin e një projektligji nga një deputet i Kuvendit.

E dyta, unë kam harxhuar goxha kohë, së bashku me ekspertë, flas për propozimin tim për ndryshimin e Kodit, për hapjen e listave, për ndryshimin e sistemit, i cili është mbështetur nga firmat e 50 mijë qytetarëve. Damian, nuk është marrë seriozisht, nuk është konsideruar fare, nuk jam duke folur për Këshillin Politik, sepse sinqerisht nuk më intereson fare, sepse nuk ka asnjë lloj rëndësie dhe legjitimiteti, përveçse për të krijuar fabula.

Por nga ky komision, nga ju personalisht, por edhe nga të dy ju si bashkëkryetarë, përfshi këtu edhe Rudinën, nuk është bërë mjaftueshëm që propozimet tona të merren seriozisht dhe të trajtohen me debate.

Të lutem, kam edhe një problem tjetër që lidhet me metodologjinë e mbledhjeve të këtij komisioni dhe besoj se do të gjej edhe mirëkuptimin e kolegëve të tjerë. Në fund të fundit, Damian, jemi një komision parlamentar dhe si në çdo parlament, parlamenti është vendi ku bëhen debate, bëhen sherre, do të ketë përplasje, për këtë punë jemi në këtu, sepse nuk bëjmë as domate, as kastravecë, as rrugë dhe as lekë nuk po vjedhim, por bëjmë fjalë dhe fjalët dhe debatet janë të nevojshme.

E para, na sillni këtu përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, të cilët në fillim hyjnë vetëm me iniciale, gjë që nuk është etike.

E dyta, ata hyjnë dhe janë prezent këtu pa foto dhe pa video dhe as kjo nuk është etike.

E treta, nuk na u shpjegua se kush e kush...

**Myslim Murrizi** – Po ata janë si bilbilfryrësit.

**Ralf Gjoni** – Më fal, Myslim!

E treta, meqë është me dyer të mbyllura, besoj se nuk jemi në media, apo jo Damian?

**Damian Gjinkuri** – Ti mund ta kesh lidhur, por nuk ka problem, sepse e ke këtë mundësi.

**Ralf Gjoni** – Unë nuk jam me dy fytyra, Damian, nuk e luaj bishtin, më beso...

**Damian Gjinkuri** – Po foto do të bësh...

**Myslim Murrizi** – Damiani të paragjykon, meqë ke punuar me Metën dhe është i sojtit të çimkave te videos, mendon se je edhe ti.

**Ralf Gjoni** – Damian, në jetën time nuk kam bërë ndonjëherë video dhe as në Amsterdam nuk kam punuar, këtë ta garantoj.

Meqë kam ardhur nga jashtë, këto 10-11 vjetët e fundit jam marrë me marrëdhëniet ndërkombëtare në politikë, besoj se kam tagrin dhe autoritetin t'u them dy fjalë edhe përfaqësuesve të nderuar ndërkombëtarë, sidomos përfaqësuesve shqiptarë të institucioneve ndërkombëtare në këtë komision. Kijeni parasysh se ne jemi deputetë që e kemi marrë seriozisht betejën tonë për ndryshimin e sistemit zgjedhor, po ju flas shumë sinqerisht dhe nuk po përmend emra për momentin, sepse nuk ka ardhur ende koha që të flasim me emra. Kini kujdes, sepse disa përfaqësues të huaj, disa prej eprorëve tuaj, po bëjnë një lojë të ndyrë politike prapa skenave për të rehabilituar figura të vjetra të djegura politike. Merreni si të doni këtë mesazh nga ana ime si deputet, por besoj se edhe deputetë të tjerë e ndajnë këtë opinion, por meqë ju jeni prezent në këtë komision dhe meqë këtu flitet hapur dhe flitet me shpirtin e debatit, se nuk jemi NGO për të rehabilituar të drejtat e fëmijëve, të grave apo të komuniteteve të tjera, që duhet të flasim vetëm me korrektësi politike, këtu jemi të detyruar të jemi *politically incorrect* që të flasim hapur.

Mbani parasysh se çdo tentativë e kujtdo përfaqësuesi të huaj për të rehabilituar dhe për t'u shërbyer figurave të vjetra, të djegura politike apo axhendave të caktuara politike, do të marrë përgjigjen e duhur, qoftë medietikisht, qoftë zyrtarisht me letra, qoftë duke u shkruar kancelarive, të cilat ju përfaqësoni apo qoftë edhe duke ekspozuar skandale. Unë personalisht posedoj fakte për mënyrën e involvimit të dy-tre përfaqësuesve të huaj në shërbim të axhendave të caktuara politike. Po ju flas shumë-shumë hapur, po ju flas shumë miqësisht, mund t'i informoni eprorët tuaj që të kenë shumë kujdes, sepse kjo do t'u ekspozohet.

E fundit, Damian, të lutem, a ka mundësi, se e kemi kërkuar që vitin e kaluar, të kemi një kalendar punimesh me një agjendë të caktuar? Kështu punohet në të gjithë botën, kështu punohet në një kompani private, kështu punohet në parlament, në qeveri, pra në të gjithë botën serioze. Ne jemi i vetmi shtet që jemi bërë qepaze, ku edhe i huaji më inkompetent, që nuk kalon dot as shkollën e mesme, vjen këtu e tallet me ne, Damian. Kjo është e turpshme se si ne e bëjmë veten për t'u tallur.

**Damian Gjikhuri** – Mbarove tani, se po përsërit veten?

**Ralf Gjoni** – Jo, nuk mbarova. Ti fole dhe unë të dëgjova, ndaj do të më dëgjosh edhe ti mua!

**Damian Gjikhuri** – Të dëgjova, por po del jashtë teme normalisht.

**Ralf Gjoni** – Jo, nuk po dal. Kjo lidhet me metodologjinë. Të lutem, ne nuk jemi këtu për fabula të këshillit politik, por duhet të trajtojmë propozimet.

Unë kam nevojë të di si nga ty, si nga Rudina, dhe dua një përgjigje konkrete, përse nuk janë marrë në trajtim dhe pse nuk kemi një seancë të posaçme të gjatë me dyer të mbyllura, me ose pa përfaqësues ndërkombëtarë, si ta duash ti, për propozimet që kam sjellë unë, zoti Murrizi dhe kolegë të tjerë, si dhe grupi tjetër i deputetëve të opozitës. Pse nuk i kemi në këtë seancë dhe pse po shtyhet, Damian, trajtimi i këtyre propozimeve?

**Damian Gjikhuri** – Ta shpjegoj unë. Mbarove tani, Ralf? Faleminderit!

Dua të them dy gjëra para se ta marrë fjalën Rudina apo edhe anëtarë të tjerë, të cilët jam i bindur se duan të flasin.

Dua të shpjegoj një gjë një herë: të mos u kthehemi gjërave që i kemi trajtuar. Ky komision ka pasur agjendë dhe ne kemi bërë disa mbledhje. Këtu kanë kaluar ose të paktën janë diskutuar një sërë paketash për të gjitha çështjet, për të cilat ishim dakordësuar se duhet të trajtohen.

Nuk po i kthehem sërish problemit të këshillit politik. Po ju them se ky i fundit është një organizëm konsultativ që ka materializuar atë vendim të Kuvendit, që edhe ju e keni votuar. Cili ka qenë vendimi i Kuvendit? Ka qenë që Komisioni i Reformës Zgjedhore të kishte edhe përfaqësues nga opozita jashtëparlamentare. Natyrshëm, ata nuk erdhën. Gjetëm një zgjidhje që të dialogojmë, ku ju aty përfaqësoheni, keni edhe zonjën Hajdari që natyrshëm përfaqëson mendimin e opozitës parlamentare, unë përfaqësoj maxhorancën dhe, natyrshëm, pala tjetër përfaqësohet nga dy persona që përfaqësojnë opozitën jashtëparlamentare. Pra, nga pikëpamja e agjendës, gjithçka ka qenë transparente dhe këtu është diskutuar. Çfarë është diskutuar në agjendën e këshillit politik që, gjithashtu, ka qenë publike dhe transparente? Të gjitha temat që përmenden aty janë diskutuar. Opozita ka ardhur me propozime dhe një pjesë e propozimeve, siç tha eksperti, janë akomoduar, ndërsa për një pjesë të tyre ka ende çështje që kërkojnë dakordësi.

Zonja Hajdari, siç e thashë, në seancën e fundit të këshillit politik, që përkonte edhe me afatin që i kishim vënë vetes, solli propozime për sistemin, ashtu siç edhe ju të tjerët sollët propozime për sistemin. Natyrisht, çfarë thashë? Nëse do ta ezaurojmë punën në një afat të shkurtër me këshillin politik në këto pak javë të majit, natyrisht që çështja pastaj do të rimerret dhe do të vazhdojmë Komisionin e Reformës Zgjedhore, ku, e thashë që në fillim, meqenëse Partia Demokratike nuk trajtoi çështje të sistemit, nuk solli propozime për sistemin,

dhe unë kuptoj që ata nuk kanë propozim për sistemin ose ndoshta nuk kanë as dëshirë ta ndryshojnë sistemin aktual, kështu e kuptova unë, qofsha i gabuar, çështja e sistemit do të diskutohet këtu.

Pyetja që unë bëra për ekspertët do t'ju ndihmojë edhe ju për debatin, sepse në debat nuk do të përsërisim deklaratat tona politike për sistemin se cili sistem është më i mirë, sepse secili ka opinionin e tij. Bota prandaj është e bukur, se secili ka opinionin e tij, por puna është vendimmarrja. Pra, që ata të na ndihmojnë në vendimmarrje, pyetja e parë që shtrohet është: këto propozime që u sollën kërkojnë ndërhyrje kushtetuese? Nëse po, atëherë së bashku do të vendosim si do ta bëjmë këtë proces dhe kemi rënë dakord politikisht që, nëse çështja e sistemit zgjedhor mund të kërkojë më shumë kohë, kemi thënë që në fillim do të kalojmë paketën e parë, që ka të bëjë me administrimin zgjedhor, pastaj me sistemin.

Megjithatë, ju e keni në dorë, sepse mund të keni votat t'i bllokoni. Unë nuk kam ç' t'ju bëj aty, nuk ju detyroj që të them do të votoni në këtë mënyrë ose jo. Secili na gjykon, por e rëndësishme është që, siç e thashë, çështjet do të diskutohen këtu dhe asnjë nuk është i përjashtuar. E përsëris, konsultimi politik me opozitën jashtëparlamentare është një gjë atipike, por e tillë është situata në Shqipëri dhe ne duhet t'i përgjigjemi asaj situatë atipike politike.

Ralf, fole njëherë tani, kështu që radhën e ka... A ka ndonjë anëtar tjetër që do të flasë?

**Ralf Gjoni** – Për të sqaruar, Damian.

**Damian Gjiknuri** – Të mos e bëjmë debat tani, se nuk shkon tani!

**Ralf Gjoni** – Nuk po e bëj debat, të lutem, dua...

**Klotilda Bushka** – Damian, e dua edhe unë fjalën.

**Damian Gjiknuri** – Po.

Atëherë, fjalën e kanë zoti Hyseni dhe zonja Bushka.

**Ralf Gjoni** – A mund ta shpjegoj?

**Damian Gjiknuri** – Hë, more, shpjego përsëri!?!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar, zonja Hajdari!

Nuk po ju vlerësoj të dyve sidrejtues komisioni...

**Ralf Gjoni** – Damian, të kërkoja fjalën. Më fal, Alket!

Alket, të kërkoj ndjesë, por unë kërkoja fjalën!

**Damian Gjiknuri** – E merr prapë në fund, le të mbarojë zoti Hyseni.

**Ralf Gjoni** – Ç'është kjo punë tani?! Ç'më mbyll mikrofonin?!



**Damian Gjikhuri** – Po çfarë do të thuash më shumë?

**Ralf Gjoni** – O Damian, a ka mundësi ta hapësh mikrofonin, të lutem?

**Damian Gjikhuri** – Dakord, thuaje, një minutë. Vazhdo!

**Ralf Gjoni** – O Alket, po si hyn ti, more, vëlla? Në qoftë se ti kishe kërkuar fjalën, unë nuk të hyja ty. Ç'janë këto tani?!

**Damian Gjikhuri** – Zoti Gjoni, t'u dha fjala prapë. Çfarë do të thuash?

**Alket Hyseni** – Ka drejtues aty, nuk e marrim fjalën kur të duam ne.

**Damian Gjikhuri** – Normale.

**Ralf Gjoni** – Të lutem tani, se...

**Damian Gjikhuri** – Zoti Gjoni, të lutem, përqendrohu tek ajo që do të thuash.

**Ralf Gjoni** – Po pra, atëherë...

**Alket Hyseni** – Qetësohuni, zoti Gjoni, qetësohuni!

**Ralf Gjoni** – Nuk jam...

**Damian Gjikhuri** – Çfarë do të thuash? Vazhdo pra.

**Ralf Gjoni** – Atëherë, me sa kuptoj unë nga ajo që the ti, Damian, ju keni vullnetin politik që, nëse këshilli politik dështon brenda këtij muaji, me sa duket drejt asaj po shkon, ju ta shtyni mandatin e Komisionit të Reformës Zgjedhore për ta trajtuar këtë bashkërisht, duke përfshirë edhe propozimet tona pas majit dhe qershorit, por a jeni në dijeni ju që pas qershorit çdo ndryshim i sistemit nuk ka asnjë vlerë, sepse duhet të paktën një vit para zgjedhjeve? Pra, çfarë po luani këtu? A ka mundësi që ne t'i trajtojmë propozimet tona, pavarësisht fabulës së këshillit politik brenda majit? Ju kërkova një agjendë.

**Damian Gjikhuri** – Ku e ke dëgjuar këtë që një vit para zgjedhjeve nuk ka asnjë vlerë ndryshimi i sistemit?

**Ralf Gjoni** – Do të ndryshojmë Kodin Zgjedhor.

**Damian Gjikhuri** – Është tjetër gjë. Sistemin ku e ke? Konsultohu mirë, sepse kam frikë që nuk je konsultuar mirë.

**Ralf Gjoni** – Jam konsultuar mirë.

**Damian Gjikhuri** – Kodin do ta miratojmë në qershor, pasi ajo që thatë ju, periudha 1-vjeçare, është afati optimal për përgatitjen e zgjedhjeve dhe jo për formulën si ndahen mandatet. Kështu që, mos i ngatërro gjërat.

**Ralf Gjoni** – Dakord, por te Kodi propozimi im nuk lidhet vetëm me ndryshimin e sistemit dhe ndryshimet kushtetuese, por një nga propozimet e mia në projektligj është për

hapjen e listave, e cila mund të trajtohet pa prekur Kushtetutën dhe pa ndryshuar sistemin si pjesë e Kodit Zgjedhor.

**Damian Gjikhuri** – Zoti Gjoni, kur njeriu fokusohet tek ajo që do të thotë, nuk dëgjon çfarë thotë tjetri. Unë thashë që të gjitha propozimet që u sollën në tavolinë, përfshirë edhe propozimin tuaj, u janë dhënë ekspertëve për të përcaktuar si do të ecim. Pyetja është: Propozimet që na kanë sjellë mund të trajtohen në Kodin Zgjedhor apo kërkojnë ndryshime kushtetuese, përfshirë edhe propozimin e Murrizit, Hajdarit dhe propozimin e Gjonit? Kështu që, kjo është çështje e ezauruar.

**Ralf Gjoni** – Ju lutem, dua të më thoni zyrtarisht datën kur ju janë dërguar ekspertëve.

**Damian Gjikhuri** – Ekspertëve u janë dhënë të gjitha draftet në mbledhjen e fundit të Këshillit, në mos gaboj në datën 9 mars. Për arsye të periudhës së pezullimit si pasojë të pandemisë, jo se ekspertët nuk kanë punuar, nuk është normale që unë të them pse nuk e kanë bërë ekspertët kur gjithçka ngriu për sa i përket punës.

**Ralf Gjoni** – Propozimin unë e kam bërë në janar. Nuk po kërkoj gjë tjetër veçse transparencë, marrje seriozisht dhe me konsideratë të një propozimi që kemi bërë.

**Damian Gjikhuri** – Ju e keni sjellë kërkesën i pari, por erdhën edhe disa kërkesa të tjera dhe tani do të shikohen të gjitha bashkë.

Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, kryetar!

Edhe një herë komplimente për organizimin e kësaj mbledhjeje në një periudhë të vështirë, por besoj që është i domosdoshëm komunikimi me anëtarët e komisionit! Ky është një komision absolutisht i domosdoshëm për këtë reformë. E para, dua të qetësoj të gjithë kolegët e opozitës që të mos kenë asnjë merak, sepse unë besoj që nuk ka asnjë shans që çdo marrëveshje e mundshme, sido që të jetë ajo, të mos kalojë në filtrin e këtij komisioni.

Nga ana tjetër, zoti Gjikhuri, zonja Hajdari, ju jeni të dy përfaqësues, njëri i maxhorancës dhe tjetri i opozitës parlamentare, në këshillin politik të reformës, në të cilin ne e kemi ezauruar miratimin dhe autorizimin tuaj në këtë Këshill. Unë besoj që është domosdoshmëri vazhdimi i filozofisë së dorës së shtrirë dhe i konsultimit me të gjithë aktorët dhe faktorët politikë në Shqipëri. Unë mendoj që asnjë reformë nuk mund të bëhet pa opozitën jashtë- parlamentare, por duhet ta bëjmë së bashku. Prandaj, unë besoj që ne duhet

t'u japim mbështetjen e plotë të dy bashkëkryetarëve për të vazhduar negociatat në këtë këshill politik.

Kuptohet që negociatat duhet të kenë një limit, sepse, përveçse kanë disa kufizime dhe korniza që nuk lejojnë askënd nga ju të dalë jashtë tyre, në radhë të parë kanë të bëjnë me parimet kryesore dhe rekomandimet që janë domosdoshmëri për t'u plotësuar. Janë rekomandime të OSBE/ODIHR-it dhe ne e kemi thënë që ato duhet të plotësohen në mënyrë kategorike. Produkti i atij Këshilli dhe nëse jo i atij Këshilli do të kalojë patjetër në Komision dhe do të jenë ato rekomandime.

Përtej kësaj, ne kemi thënë që ka edhe disa pretendime dhe shqetësime.

**Myslym Murrizi** – Jo domosdoshmëri do të kalohen rekomandimet, Alket. Jo të gjithë, mos na fut të gjithëve.

**Damian Gjikhuri** – Zoti Murrizi, ju lutem, mos e ndërprisni!

**Alket Hyseni** – Ju lutem, kolegë, të mos e ndërpresim njëri-tjetrin, sepse unë do të dëgjoj gjithsecilin. Unë po them këndvështrimin tim dhe të maxhorancës besoj.

**Myslym Murrizi** – Unë nuk i votoj rekomandimet nëse nuk preket thelbi.

**Alket Hyseni** – Rekomandimet nuk janë të sotme, por të disa raporteve.

**Myslym Murrizi** – Janë që të kohës së Skënderbeut.

**Damian Gjikhuri** – Zoti Murrizi, ju lutem!

**Myslym Murrizi** - Zoti Gjikhuri, të flasë në emrin e vet, jo në emrin tim.

**Damian Gjikhuri** - Ai flet për veten e vet, për maxhorancën, kurse ju folët për veten tuaj.

**Alket Hyseni** – Myslym, pse ngatërrohem? Unë nuk përfaqësoj komisionin. As Damiani nuk e përfaqëson dot vetëm, sepse janë dy bashkëkryetarë. Të gjithë juve ju përfaqëson Rudina, kurse Damiani na përfaqëson neve dhe ka të gjithë mbështetjen tonë, ashtu siç jam i bindur që edhe Rudina ka mbështetjen tuaj. Ndaj t'i lëmë të bëjnë punën. Unë po flas këtu në emrin tim dhe të maxhorancës.

**Myslym Murrizi** – Për të votuar rekomandime koti nuk e ka mbështetjen time askush.

**Alket Hyseni** – Të nderuar kolegë, ndoshta jemi edhe në media dhe na dëgjojnë edhe qytetarët, OSBE/ODIHR-in ne e kemi marrë për prift dhe nuk mund t'i rruajmë mjekrën. Ai është institucioni më ekspert që njih bota demokratike.

**Myslym Murrizi** – Alket, unë jam mysliman, nuk kam punë me priftin. Prandaj ke lënë mjekër?

**Alket Hyseni** – Po je shqiptar, e di që është shprehje popullore shqiptare.

**Myslim Murrizi** – Dakord, por fol për ata që ...

**Alket Hyseni** – Pse më ndërpret, Myslym, sepse unë nuk të ndërpreva dhe nuk kam për të ndërprerë asnjëherë?

**Myslim Murrizi** – Mos më ofendo fenë, Alket! Fol për ata që kanë frikë OSBE-në, kurse mua nuk më impresionon asnjë lloj organizmi.

**Damian Gjikhuri** – Mos e bajatosni bisedën.

**Alket Hyseni** – Nëpërmjet disa raporteve ne kemi marrë rekomandime nga këto institucione, të cilat janë lidere të ekspertizës në shoqëritë demokratike botërore. Këto rekomandime në radhë të parë janë teknike, të cilat ne do t'i adresojmë dhe janë ekspertët që po punojnë, kurse ne do të japim në fund mendimin politik me votën tonë. Pastaj ka vend për të diskutuar. Kemi rënë dakord dhe ky komision ka dalë me vendimin që këto rekomandime do të adresohen. Ne nuk mund t'i rikthehemi sa herë bëjmë mbledhje vendimeve që vetë ky komision ka marrë.

Nga ana tjetër, unë thashë që ne duhet të vazhdojmë ta kemi dorën e shtrirë. Duhet t'ia lëmë atë dritare politike të hapur opozitës joparlamentare, jo vetëm se është domosdoshmëri prania e saj, por edhe për të marrë ekspertizën, sepse ne besojmë që brenda saj ka ekspertë, të cilët mund të na japin sugjerimet e tyre, që mund të jenë të vlefshme. Ama kjo duhet të ketë limit. Ne kemi edhe një kufizim tjetër. Procesi integrues është një kufizim kohor. Ne nuk mund të rrimë pa fund të presim këdo aktor apo faktor politik, në tekat e tyre apo në lojërat e tyre të brendshme. Ne këtu nuk duhet të bëjmë politikë, ne duhet të kemi një afat, t'i themi këshillit që ju deri në këtë datë keni kohë apo një periudhë kohe dhe pas kësaj, ky komision, me ekspertët që ka marrë, me partnerët, duhet ta vazhdojë punën vet. Prandaj, nuk dua të zgjatem, është e rëndësishme të adresojmë problematikat.

Ne si maxhorancë kemi pasur një problematikë lidhur me votën e emigrantëve. Ne kemi kërkuar të adresohet vota e emigrantëve. Le të shohim sa do të jemi në gjendje ta adresojmë dhe nëse jo në këto zgjedhje, ne duhet patjetër ta parashikojmë për në zgjedhjet e tjera, sepse është një domosdoshmëri, kemi thënë.

Po ashtu, opozita parlamentare ka një shqetësim, lidhur me sistemin, t'ua u lëmë ekspertëve të na sjellin komplikimet që sjell, pasojat që sjell, konsekuencat që sjell dhe ne jemi këtu për të marrë vendimet, pastaj. Ne kemi ftuar aktorët e shoqërisë civile, të cilët janë po ashtu shumë të rëndësishëm, brenda tyre ka ekspertizë të vyer, do ta vjelim të gjithë atë ekspertizë dhe do të dalim me një vendim. Thjesht të jemi të duruar, të organizuar dhe të

mundohemi që të jemi sa më shumë. Tek e fundit, produkti duhet të vijë nga ky komision dhe do t'i përcillet Parlamentit. Ky është filtri i fundit. Le të rrinë të qetë të gjithë kolegët.

Nuk e di, dëgjohem kryetar?

**Damian Gjikhuri** – Po.

**Alket Hyseni** - Le të rrinë të qetë të gjithë kolegët. Secili le të thotë mendimin e vet. Të lëmë njëri-tjetrin të diskutojë dhe të vazhdojmë punën. E rëndësishme është që ne po punojmë. Deri para pak ditësh, shumë nga kolegët kanë shprehur shqetësimin se kur do të mblidhemi. Ja u mblodhëm, të mandatojmë kryetarët të bëjnë punën, të mbështesim ekspertët të vazhdojnë punën, që të vijnë të na raportojnë produktin e tyre dhe në qershor, patjetër, pse jo, të kemi edhe vendimmarrjen përkatëse.

Ju falënderoj!

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit, zoti Hyseni, për kontributin tuaj dhe për fjalën shumë paqtuese dhe shumë inkurajuese për punën!

Zonja Klotilda Bushka kërkoi fjalën.

**Klotilda Bushka** - Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje dy bashkëkryetarëve! Përshëndetje kolegë, uroj të jeni mirë vetë dhe në familjen tuaj, së bashku dhe me të ftuarit.

E vlerësoj organizmin e kësaj mbledhjeje sepse është një çështje primare e interesit publik. Mbasi jam njohur me memon, kam disa pyetje dhe disa sugjerime, për të ecur me çështjet e thelbit, për të mos diskutuar çështjet e përgjithshme.

Në radhë të parë, kemi vendosur në këtë komision që, pa diskutim, ne do të kemi një diskutim gjithëpërfshirës, sepse reformat zgjedhore nuk janë reforma që u përkasin vetëm politikanëve, janë reforma që i përkasin popullit dhe në qoftë se nuk ka vullnet nga shumica e aktorëve politikë, që janë përdoruesit e parë të ligjeve zgjedhore, nëse nuk ka një konsensus dhe një dakordësi për pjesën më të madhe të çështjeve, ne nuk do të arrijmë dot të fitojmë besimin e publikut te sistemi zgjedhor. Ky duhet të jetë qëllimi ynë primar, siç ka qenë në krye të herës. Pra, ne po bëjmë një reformë zgjedhore, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, duke adresuar rekomandimet e ndërkombëtarëve, që në fund të fundit, t'u shërbejë qytetarëve shqiptarë, ata të kenë besim te sistemi dhe kështu, rrjedhimisht, të kenë besim edhe te përfaqësuesit që zgjidhen nëpërmjet votës.

Kështu që, unë nuk e shikoj vetëm si një shtrirje dore ndaj opozitës jashtëparlamentare formimin e këshillit politik, por e quaj një përgjegjësi tonën, neve, që jemi në Kuvend, që përfaqësojmë anë të ndryshme politike, për ta realizuar këtë interes, në të mirë

të shqiptarëve. Gjithsesi, jam dakord me zotin Hyseni që gjithë bashkëpunimi, gjithë diskutimi jashtëparlamentar dhe brendaparlamentar, është i lidhur me afate, sepse çështjet e mira nuk mund të ecin pambarimisht dhe të mos kenë një fund.

Do të inkurajoja vijimin e diskutimeve në këshillin politik, ashtu si, paralelisht, punën në Komisionin e Reformës Zgjedhor për ato çështje, që sipas memos që na është dërguar, tashmë është arritur në një lloj konsensusi dhe këtu, për të dy bashkëkryetarët do t'i referohem memos së dërguar nga sekretaria e komisionit.

Përsëritës dhe përgëzoj faktin që grupi i ekspertëve teknikë dhe këshilli politik kanë miratuar me konsensus disa propozime për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin Penal, në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, në ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe disa ndryshime në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Unë mendoj se, nëse këto drafte janë në formën e tyre finale, pa vënë nën presion askënd, sepse edhe perioda e COVID-it është e mirëkuptueshme, të gjithë kanë pasur vështirësitë e tyre, pavarësisht se mund të kenë punuar, po nëse janë në formën për t'u shpërndarë midis anesh, unë do të kërkoja që, nëse ndahen, të kishim paralelisht edhe në këtë punë, në mënyrë që kur të vijojmë procesin, të kemi ezauruar çështjet për të cilat nuk ka më diskutime dhe të arrijmë të marrim vendimmarrjen në punën e komisionit të Reformës Zgjedhore dhe hap pas hapi, të vijmë të çështjet e tjera, për t'u diskutuar bashkërisht këtu.

Unë besoj se ne do të kemi, siç kemi vepruar gjithmonë dhe këto janë dhe proceduar parlamentare, një kalendar të aktiviteteve të komisionit dhe sugjeroj që kur të bëhet kalendari, për ato çështje që kanë një dakordësi të plotë, e mira është të jenë në rendin e ditës, që ne t'i kalojmë hap pas hapi. Gjithsesi, është një sugjerim imi, dy bashkëkryetarët dhe anëtarët e tjerë të komisionit mund të kenë mendimin e tyre, por kjo, për gjykimin tim, i shërben edhe ekonomisë së kohës, por edhe arritjes sa më shpejt të qëllimit.

Tani kam një pyetje për çështjet e parashtruara në memo, që janë çështje shumë të rëndësishme, në fakt. Ne e kemi shprehur vullnetin tonë që kompozimi i administratës zgjedhore, çështja e depolitizimit të administratës zgjedhore, si dhe kompozimi i kolegjit zgjedhor, në përputhje me standardet ndërkombëtare por edhe me dinamikën e ndryshimeve ligjore që ka pësuar Shqipëria, kryesisht edhe për sa i takon reformës në drejtësi, do të ishin çështje që do të adresoheshin nga reforma. Unë shikoj që për këto dy çështje nuk janë bërë përpjekje që të finalizohet puna për amendimet në Kodin Zgjedhor, por është rënë dakord që

të vijojë puna e Kolegjit Zgjedhor, deri në një periudhë të caktuar kohe, me logjikën që Gjykata Administrative e Apelit të jetë ajo që zëvendëson kolegjin e sotëm zgjedhor.

Një pyetje kam për këtë. E kuptoj që nuk është rënë dakord dhe nuk do të jenë menjëherë pjesë e diskutimeve, sepse duhet arritur në një dakordësi, por nëse ka një informacion më të zgjeruar në lidhje me propozimet dhe diskutimet, mendoj se do të ishte në interes të të gjithëve të njiheshim me to.

E fundit, në qoftë se ne i kemi prekur këto çështje, që unë i përmenda apo edhe të tjerat, që janë memo dhe nëse ne do të kemi ndryshime në Kodin Zgjedhor mbi më shumë se 50% të tij, a është ndoshta rasti për të diskutuar për të pasur një kod të ri zgjedhor, jo për të bërë ndryshime në kodin ekzistues? Nuk e di a ka pasur diskutime në lidhje me këtë çështje.

Faleminderit!

**Damian Gjiknuri** – Faleminderit, zonja Bushka!

Po ju jap nja dy shpjegime në lidhje me pyetjet tuaja dhe ju falënderoj se mbase propozimi është me shumë vlerë. Edhe unë e kam pasur këtë ide, por mbase periudha intensive e negocimit në këshillin politik nuk na lejoi që për paketat për të cilat ishim dakordësuar, t'i diskutonim edhe në komisionin e reformës për ta ambalazhuar plotësisht të gjithë paketën përkatëse përpara se nesër të kemi të gjithë tekstin integral për ta çuar në parlament për ta miratuar.

Kështu që, kjo është një gjë të cilën do ta diskutojmë dhe mendoj se është e mundshme, pra ato gjëra, për të cilat vërtet kemi gjetur dakordësi, s'ka pse të mos diskutohet edhe në komisionin e reformës zgjedhore dhe të jetë një paketë e gatshme. Kur i gjithë kodi bashkë me ligjet shoqëruese përkatëse do të kalojnë njëkohësisht në seancë plenare, prandaj ka shumë vlera ajo që thatë.

Tek ajo pjesa e kolegjit, nëse e kuptova drejt, nuk do të rrijë ky kolegji, pra këta anëtarë të kolegjit. Çështja është se si do të jetë formula për zgjedhjen e kolegjit zgjedhor deri sa të mbarojë procesi dhe të krijohet gjykata administrative e apelit.

E shpjegoi edhe eksperti, ideja është që në finale gjykata administrative e apelit do të jetë organi që do të gjykojë mosmarrëveshjet zgjedhore dhe besoj se drejt asaj duhet të shkojmë dhe kjo është krejt normale, por derisa të krijohet ajo gjykatë (pra, le të themi kanë kaluar vetingun, është plotësuar me numrin përkatës të gjyqtarëve) do të operojmë në mënyrë tranzitore me formulën e kolegjit zgjedhor, ku diskutimi i vetëm ka qenë a do t'i zgjedhim nga personat që kanë kaluar vetingun apo persona të cilët do të jenë edhe përtej pull-it.

Këtu ka një diskutim akoma dhe po përpiqemi për një formulë kompromisi. Vullneti ynë ka qenë dhe përgjithësisht ndërkombëtarët kanë qenë të mendimit që të zgjidhen nga pull-i i personave të cilët kanë kaluar vetingun jo vetëm në Apel, por edhe në shkallë të parë dhe qëndrimi ynë si maxhorancë ka qenë pro kësaj, kurse opozita ka pasur kundërshtitë e saj. Por të jemi të qartë, nuk do të rrijë ky kolegji zgjedhor, sepse këtij i ka mbaruar mandati dhe ky kolegji ka rënë, pra bëhet fjalë për kolegjin e ri deri sa të krijohet gjykata administrative e apelit e plotë, pasi të ketë përfunduar vetingun dhe pasi të ketë plotësuar mandatin.

Urdhëroni, zoti Nimet!

**Nimet Musaj** – Faleminderit, bashkëkryetarë, zoti Gjiknuri dhe zonja Hajdari!

Të nderuar kolegë,

Përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë,

Kjo është një seancë informuese dhe ju falënderoj që pas kaq kohësh ne jemi përsëri bashkë, pavarësisht se në distancë.

Dua të mbështes një propozim që bëri kolegu Murrizi, që ndoshta do ta theksojmë në diskutimin që do të kemi për sistemin zgjedhor, që është një kauzë e opozitës (ndoshta në sallën e seancës plenare të mbledhjes për ta bërë më të hapur dhe për të qenë prezentë).

Unë do të vlerësoja një nga kushtet e BE-së për hapjen e negociatave, që është reforma zgjedhore. Meqë jemi në periudhën maj-qershor, do të vlerësoj punën që është bërë në këshillin politik, ku kemi rënë dakord midis palëve për gjashtë aspekte. Pjesa tjetër është administrata zgjedhore që është nga më të rëndësishmet në këtë moment.

Vlerësoj punën dhe dakordësinë për të afruar datën e zgjedhjeve në periudhën prill-maj të vitit të ardhshëm, duke parë eksperiencën negative për turizmin në vitet e shkuara.

Opozita kërkon dhe do të diskutojë sistemin me propozimet e kolegëve që janë në tavolinë.

Eksperti bëri një rezymë të qartë dhe korrekte se çfarë është bërë dhe çfarë do të bëhet në të ardhmen. Unë mendoj se diskutimi për sistemin zgjedhor do të ketë dakordësinë për të kaluar edhe propozimet e tjera.

Rekomandimet e OSBE/ODIHR-it kanë qenë pjesë e të gjitha paketave për të cilat jemi dakordësuar dhe mendoj se duhet ta përfundojmë brenda asaj periudhe për të cilën kemi rënë dakord.

Faleminderit!

**Damian Gjiknuri** - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Hysi!



**Vasilika Hysi** – Faleminderit, bashkëkryetarë!

Të nderuar kolegë,

Unë do të doja t'ju falënderoja për informacionin e përcjellë në rrugë elektronike. Nga studimi i informacionit të përgatitur rezulton se këshilli politik ka arritur konsensusin për 13 çështje dhe në këtë kuadër do të inkurajoja dhe do të kërkoja si anëtare e këtij komisioni që produkti për të cilin është dakordësuar të vihet menjëherë në dispozicion të anëtarëve të komisionit. Të paktën, unë do të doja ta kisha.

E dyta, konstatoj shumë propozime për ndryshime në ligje me shumicë të cilësuar, si Kodi Penal, ligji “Për statusin e gjyqtarit” apo Kodin e Procedurës Penale. Nuk flas dot për këto ndryshime pasi nuk i kam parë, por nga përvoja ime theksoj se në këto vitet e fundit komisionet e reformës zgjedhore, ku unë kam bërë pjesë, kanë prekur dhe kanë amenduar Kodin Penal dhe nuk kam parë që opozita jashtëparlamentare të ndihet e kënaqur edhe me ndryshimet që propozoi vetë në vitin 2012 dhe në vitin 2017, pas marrëveshjes së prillit 2017.

Në këtë kuadër do të doja më shumë të fokusoheshim te përmbushja e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it në raportet e fundit.

Në informacion thuhet se lidhur me kuotat gjinore ka mendime të ndryshme. Do të doja të dija më shumë se pse opozita jashtëparlamentare nuk është dakord lidhur me propozimin që na kanë përgatitur ekspertët në komisionin e reformës zgjedhore dhe cilat janë mendimet që ka ky këshill politik, ose cila i ka, opozita jashtëparlamentare? Në fakt, periudha që ne kemi dakordësuar për ta shtyrë Komisionin e Reformës Zgjedhore deri në muajin qershor, në vlerësimin tim, nuk është e mjaftueshme me këto ritme që po ecën këshilli politik. Unë e kuptoj dhe jam dakord me atë që tha zoti Hyseni se ne duhet t'i shtrijmë dorën opozitës jashtëparlamentare, por, nga ana tjetër, jemi institucione të ligjshme, jemi shprehës të sovranitetit të popullit dhe, në këtë kuadër, mbajmë përgjegjësi. Nuk është opozita jashtëparlamentare ajo që mban përgjegjësi për përmbushjen ose jo në kohë të reformës zgjedhore, por jemi pikërisht ne, të cilët jemi mandatuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Koha që thoni se brenda muajit maj do të vazhdojë punën këshilli politik dhe më pas në muajin qershor do të kalojmë në diskutime në komision, nuk më duket aspak e drejtë, pasi ndryshimet në Kodin Zgjedhor, për më tepër një Kod i ri, sikurse thuhet për shkak të numrit të madh të ndryshimeve, **nuk e mundëson ky komision**, sikur të mblidhet edhe përditë. Nuk e ka këtë mundësi të mblidhet përditë, pasi ne jemi çdo ditë nëpër komisione në veprimtarinë parlamentare, ku kemi dhe një sërë detyrimesh të tjera për të përmbushur si parlamentarë. Pra, koha, vetëm muaji qershor, e bën të pamundur që ne ta përmbushin në

kohë këtë detyrë. Të mos harrojmë se, me ndryshimet që janë bërë në Rregulloren e Kuvendit, seanca, të paktën duhet një javë para të marrë produktin në dorë, pra të marrë raportin, çka do të thotë që këtë proces, të nderuar bashkëkryetarë, duhet ta përmbyllim jo më vonë se data 10 qershor. Në kushte të tilla, do të sugjeroja atë që e tha me të drejtë zonja Bushka që, me mbylljen e kësaj mbledhjeje, ju të na përgatisni një projektkalendar për fillimin e diskutimit për 13 çështjet për të cilat është dakordësuar. E para, të njihemi, t'i diskutojmë, t'i dakordësojmë dhe, njëkohësisht, ju mund të punoni paralel me këshillin, por kurrësi nuk mund të mbahet peng Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Besoj se asnjëri prej nesh këtu nuk do të ndihej mirë që ne të atakohemi, madje edhe nga shumë ekspertë të jashtëm që sot janë të pranishëm në këtë mbledhje, për të thënë: "Është faji i politikës që nuk bën dot reformën zgjedhore". Jo, të nderuar kolegë, nuk është faji as i imi, as i shumë prej jush këtu, por faji është pikërisht i atij kompromisi politik që duhet të realizohet jashtë këtij parlamenti. Në këtë kuadër, do të kërkoja edhe një herë, kalendarin, e para.

E dyta, të kemi një diskutim të një ose dy çështjeve për mbledhjen, për të na dhënë kohën e mjaftueshme.

E treta, të qartësohet se kush është pro dhe kush është kundër varianteve që paraqiten. Nëse për një çështje ka më shumë se një variant, të thuhet: "Ky është varianti i opozitës jashtëparlamentare.". "Ky është varianti i opozitës parlamentare.". "Ky është varianti i maxhorancës." dhe t'i diskutojmë. Ne nuk jemi numra, nuk jemi thjesht të ngremë dorën dhe të biem dakord se çfarë thuhet në këshillin politik.

E fundit, lidhur me çështje të cilat po diskutohen gjerësisht, besoj se ne duhet të marrim një përgjigje: çfarë do të bëhet me votimin e emigrantëve, me sistemin e përdorimit të teknikës? Çfarë do të bëhet me depolitizimin? Personalisht jam për depolitizimin e administratës publike, pasi është një nga rekomandimet e përsëritura në mënyrë sistematike në këto raporte. Nuk do të më vinte aspak mirë që, me miratimin e këtij Kodi Zgjedhor, raporti i radhës i OSBE/ODIHR-it të thotë se Shqipëria nuk i përmbushi standardet, pasi, të nderuar kolegë, shumë prej nesh kanë përvojë si juristë dhe nuk mund të marrim mbi kurriz atë gjë që gjithë këta ekspertë të nderuar, vendas dhe ndërkombëtarë të përfshirë, të cilëve u kemi besuar këtë produkt, të mos arrijnë të na japim një material, një riformulim të dispozitave që së fundi do ta ndajnë Shqipërinë nga etiketimi se nuk di të bëjë zgjedhje me standarde dhe nuk ka i përmbushur rekomandimet e tij.

Në këtë kuadër, do të doja një përgjigje për çështjen e kuotave zgjedhore: pse nuk ka një dakordësi dhe çfarë kërkohet? Nëse do të kemi një kalendar, kur mund ta kemi atë që edhe ne të planifikojmë mbledhjet tona dhe t'i kushtojmë kohën e duhur studimit të nismave të dakordësuara?

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Zonja Hysi, po them dy gjëra, pasi ju prekët disa probleme që ndoshta ia vlen të sqarohen edhe të tjerët.

Për sa u përket kuotave gjinore, është normale, pasi mendoj se tani duhet të ndryshojë dhe teknologjia e informacionit për sa i përket ndarjes së disa të dhënave edhe me anëtarët e Komisionit për Reformën Zgjedhore. Jam dakord me atë që u tha edhe më sipër për gjëra, që ne kemi kompromis, mund të fillojmë shqyrtimin në komision dhe nuk e shikoj shqetësuese këtë gjë.

E dyta, për sa u përket kuotave, përgjigjja është shumë e thjeshtë: opozita nuk është dakord me atë formulë që kemi rënë dakord dhe thjesht këtu kemi mbetur. Me pak fjalë, nuk pranon idenë që 1 në 3 emra të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar, por vazhdon të qëndrojë me variantin që është në kodin aktual. ODIHR-i ka dhënë opinionin në lidhje me këto. Këtu jemi duke ushtruar, por besoj se në këtë çështje ka një dakordësi nga të gjithë aktorët ndërkombëtarë, nga të gjithë ata që kanë vëzhguar fushatat zgjedhore që Shqipëria duhet të bëjë këtë hap përpara dhe besoj se do të gjendet këtu edhe kompromisi. Një pjesë të gjërave, për të qenë i qartë, i ngriti edhe zonja Bushka pak më parë. Ne mendojmë se Kodi Zgjedhor do të reformohet i tëri, pra do të jetë një ligj i ri zgjedhor, sepse po preket 80% e tij.

Nga ana tjetër, mos mendoni se nuk është bërë punë nga ekspertët, 60-70 % e gjërave janë shumë teknike, i kemi diskutuar edhe këtu në komision dhe ato drafte besoj se do t'i shpërndajmë shumë shpejt për anëtarët, pasi të gjejmë dakordësi. Ata kapituj që kemi dakordësi me opozitën në këshill, pra të biem dakord, le të kalojnë dhe të diskutohen këtu, por gjërat e fundit të mbetura, natyrshëm që do të negociohen, pastaj do të aprovohen këtu.

Jam i bindur se ne do ta gjejmë mënyrën e komunikimit edhe për të vjelë opinionin e ekspertizës edhe mendimet e anëtarëve të komisionit për të mos ia lënë gjithçka rastësisë, sepse nuk do të diskutojmë vetëm këshill-komision zgjedhor. Kur të kemi gjetur dakordësinë, natyrshëm do ta gjejmë atë edhe duke marrë parasysh opinionet tuaja.

Nga kjo pikëpamje mos kini asnjë merak. Ajo punë do të ndodhë. Kur thashë për qershorin, thashë që Komisioni i Reformës Zgjedhore ka afat deri në qershor si komision. Parlamenti mund ta miratojë edhe në korrik, por dëshira ime është që ta miratojë në

qershor, mund ta miratojë edhe javën e parë, të dytë apo të tretë të korrikut, por ne si komision të kemi çuar produktin. Aty mbaron detyra jonë. Detyra e këtij komisioni është kur çon produktin në seancë plenare, që të zhvillohet diskutimi atje, e më pas të vendoset në bazë të vullnetit politik të të gjithë deputetëve.

Kësisoj, mos kini merak! Unë do të përgatis një kalendar në lidhje me ato gjëra që, siç thashë, kemi kaluar, por në bazë të konsultimit edhe me opozitën, mund t'i diskutojmë sërish në komision, për të marrë miratimin e për të ecur përpara.

Natyrshëm mund ta meritojë një seancë çështja e sistemit zgjedhor, por, pasi të përgjigjen edhe ekspertët, dhe ky material të shpërndahet tek të gjithë anëtarët, ne do të organizojmë një debat ose një diskutim të caktuar brenda këtij komisioni, në lidhje me problemin e sistemit zgjedhor.

Nuk e di nëse jeni dakord, me mirëkuptimin tuaj, ta përmbyllim si diskutim, sepse nuk besoj që do të kemi ndonjë gjë më shumë për të shtuar. Ky qe takimi i parë pas shumë kohësh, ndaj natyrshëm ndodhën ngjarje, që nuk i kishim parashikuar. Megjithatë, bëme mirë që e rinisëm shpejt, në maj.

Kemi një periudhë dymujore, dhe unë mendoj se, pavarësisht nga koha e shkurtër, është bërë një punë e mirë. Nëse ka vullnet edhe nga opozita jashtëparlamentare, e cila nuk ka një kartabiankë pa datë skadence, sepse nuk mund të vazhdojë pafundësisht çështja e dakordësisë ose jo, në lidhje me Kodin Zgjedhor, ne si maxhorancë dhe ky parlament e ka gjithë të drejtën legjitime, por, mbi të gjitha, ka obligimin për të miratuar një Kod Zgjedhor, pasi në lojë janë edhe procese të tjera, përveç zgjedhjeve në Shqipëri.

Besoj se duhet ta mbyllim.

Ralf, i the ato që kishe për të thënë. Nuk besoj se ka nevojë për përsëritje tani.

**Ralf Gjoni** – Nuk e kuptoj pse je gjithmonë antagonist.

**Damian Gjikhuri** – Vazhdo.

**Ralf Gjoni** – Damian, unë s'të sulmova ty.

**Damian Gjikhuri** – Unë të thashë: kërkoje te vetja.

**Ralf Gjoni** – Po lëre, se s'je doktor moral dhe politik ti! Unë të kërkoj fjalën, ti ma jep. Çfarë e ke ti, pronë private?! Se po na heq petullën me mënyrën se si po e trajton këtë komision! Ti jep fjalën. Rudina, a është aty, të lutem?

**Damian Gjikhuri** – Të lutem, do të fokusohesh tek ajo që do të thuash?

**Ralf Gjoni** – Sa herë që kërkoj fjalën, ta mbyll pra.

**Damian Gjikhuri** – Mos kalo te testosteronet, se nuk i ke aq lartë. Ulu, mbaje një çikë!

**Ralf Gjoni** – Mos na bëj tani, se e hapim edhe ne gojën për gjërat që ke bërë ti.

**Damian Gjikhuri** – Të lutem, Ralf!

**Ralf Gjoni** – A është Rudina atje, të lutem? Se nuk e shoh.

Rudina, a ka mundësi të dakordësoheni me Damianin se si menaxhohet komisioni, të lutem? Kur deputetët të kërkojnë fjalën, duhet të kenë fjalën tri herë, tridhjetë herë, njëqind herë. Për këtë punë mblidhemi.

Tani, për të dy kam një pyetje: kur do të mblidhet sërish komisioni, dhe a keni një agjendë paraprake për të dakordësuar në lidhje me mënyrën si do të procedojmë gjatë dy, tre, katër javët e ardhshme? Kaq. Ishte një pyetje normale. Nuk e di pse ke problem me transparencën, Damian?! E ke pasur gjithmonë këtë punën e futjes së dorës në xhep dhe mbylljes së kamerave.

**Damian Gjikhuri** – Më duket se ti je mësuar me ato xhepat me vrimë, më duket, ti vetë!

**Ralf Gjoni** – Do ta shohim, mos ki merak!

**Damian Gjikhuri** - Dëgjo, Ralf, unë e kuptoj se tipa si ti duan vëmendje dhe duan të krijojnë konflikte apo nxemje gjakrash, për të marrë më shumë vëmendje, por kjo për mua s'ka rëndësi, sepse nuk kam kohë për të humbur me këto gjëra. Tani, le të fokusohemi te çështjet për të cilat jemi mbledhur.

Ju thashë se shumë shpejt do t'ju informojmë në lidhje me hapat që do të ndjekim për sa i përket axhendës. Sot, së bashku me zonjën Hajdari, do t'i drejtohem zyrtarisht dhe do t'i bëjmë ftesë opozitës, pasi dje nuk i kuptova në deklaratat e tyre, nëse duan të vazhdojnë diskutimet në Këshillin Politik apo e quajnë të ezauruar me propozimet që kanë sjellë? Nëse e quajnë të ezauruar, natyrshëm çështja do të transferohet në Komisionin e Reformës Zgjedhore, ku edhe ti do të kesh kohë të flasësh sa të duash pastaj, me gjithë energjitë e tua.

**Ralf Gjoni** – Faleminderit për bujarinë, Damian! Je shumë i mirë!

**Damian Gjikhuri** – Besoj se nuk kam nevojë për...

**Ralf Gjoni** – Je tamam në traditën bajraktarike të otomanëve! Je shumë i mirë! Faleminderit për mëshirën!

**Damian Gjikhuri** – Ti je i shkollës bizantine, çfarë të them!

**Rudina Hajdari** – Është shumë e vështirë edhe mënyra se si është organizuar. Unë isha këtu gjatë gjithë kohës, i kam dëgjuar të gjithë me vëmendje se çfarë thanë. I kam shënuar të gjitha gjërat që u thanë nga opozita.

Sa i përket agjendës, jam dakord që ne duhet të kemi një agjendë më të qartë.

Ky takim duhej të kishte ndodhur kohë më parë, por nuk ka ndodhur edhe për shkak të mënyrës se si funksiononte Këshilli Politik. Gjithsesi, besoj se tashmë jemi në rrugën e duhur, kështu që do t'i shqyrtojmë të gjitha propozimet. Ju e dini shumë mirë se asnjë propozim nuk del nga komisioni pa miratimin, pra pa dakordësinë e bashkëkryetarëve. Kini një çikë më shumë besim te përfaqësuesit tuaj, që të kuptohemi dhe të gjejmë mënyrën e duhur, sepse asgjë nuk ecën përpara pa pasur dakordësi.

Unë ju dëgjoj të gjithëve me vëmendje, por, nga ana tjetër, ju duhet të kuptoni se të gjithë duhet të ecim përpara me mirëkuptim, përndryshe asgjë nuk mund të bëhet as në këtë këshill, as në komision e as parlament. Kësisoj, do të informohemi dhe do të shikojmë se si do të ecin gjërat.

Unë besoj se komisioni duhet të vazhdojë punën dhe duhet të informohet për çdo hap, sepse është i vetmi organ ligjor që mund t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat që kanë ardhur, amendimet që do t'i bëhen Kodit apo dhe shqyrtimit të sistemit, siç e tha edhe Ralfi me vend, që duhet të bëhet një seancë e veçantë. Do të biem dakord për një seancë tjetër në lidhje me sistemin, do të biem dakord edhe për një kalendar, siç e kërkoi edhe nënkryetarja Hysi, do të biem dakord edhe në lidhje me pikat e tjera që ju kërkua. Kështu që, të gjitha gjërat janë shënuar nga ne.

**Damian Gjikhuri** – Edhe një gjë të fundit, më shumë për t'ua bërë të ditur edhe anëtarëve: po sot, i kemi kërkuar zyrtarisht ODIHR-it, që të rinovojnë asistencën, sepse, pas ndërprerjes që u bë për shkak të pandemisë dhe të situatës së krijuar, ekspertët u larguan. Kërkuam zyrtarisht që ekspertët të fillojnë menjëherë punë me komisionin dhe me Këshillin Politik, në një formë që është e pranueshme. Në qoftë se s'mund të jenë fizikisht prezentë këtu, natyrshëm që asistenca do të zhvillohet *online*.

Raul, këtë e kam për ju: përshëndetje! Pra, zyrtarisht, sot do t'ju vijë kërkesa, me të cilën do të kërkojmë angazhim të menjëhershëm në lidhje me këtë çështje.

**Raul Muresan**– Faleminderit shumë, Damian! Sigurisht!

**Damian Gjikhuri** – Në rregull!

Atëherë, gjithë të mirat!

Ju uroj një ditë të mbarë!

Mirë u pjekshim së shpejti!

Mirupafshim!

## **MBYLLET MBLEDHJA**